AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë " Akademia Nehemiah Gateway"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Enis Fita
2. Dr. Erida Elmazi

Janar/2025

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**
**Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway".**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Akademia Nehemiah Gateway |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhimit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMAS nr. 573, datë 03.10.2022 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite / 4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Anglisht |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 5 PAE/ 2 PAK v.a. 2023-2024<br>5 PAE/ 1 PAK v.a. 2022-2023 |
| 18 | Numri i studentëve: | 1 Studentë v.a. 2023-2024<br>16 Studentë v.a. 2022-2023 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Përshkrim përmbledhës**

Programi i studimeve në Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway", me kohëzgjatje 2 vite, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit në Fakultetin e Biznesit dhe Menaxhimit. Ky program studimi është miratuar me Urdhrin Nr.573, datë 03.10.2022, të Minstrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilin programi Master i Shkencave në ''Lidership dhe Vlerësim Arsimor'' u organizua në ''Menaxhim'' me profil në ''Biznes''. Ky riorganizim i programit erdhi si rrjedhojë e riorganizimit të IAL-së "Akademia Nehemiah Gateway", me Vendim Nr.424, date 14.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku fusha akademike u përqëndrua në Ekonomi dhe Menaxhim.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Në përfundim të programit lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi" me profil në ''Biznes''.

Objektivi kryesor i këtij programi është të përgatisë studentë që dëshirojnë të kenë një karrierë në menaxhim, si edhe në sipërmarrje. Gjithashtu, synon të përgatisë të diplomuarit për të përballuar situata komplekse që kërkojnë aftësi të larta analitike, vendimmarrje strategjike dhe një kuptim të thellë të dinamikave të tregut dhe menaxhimit të burimeve në nivele të ndryshme organizative.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

### Përshkrim përmbledhës

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Akademia "Nehemiah Gateway", filloi me caktimin nga ASCAL si ekspertë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) të eksperteve: Dr. Enis Fita dhe Dr. Erida Elmazi. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesi i ASCAL.

Ekspertët e jashtëm u njohën paraprakisht me dokumentacionin e dërguar nga institucioni dhe, përmes ASCAL, u dakordësua mbi datat e realizimit të vizitës në institucion. Bazuar në dokumentet e disponueshme, filloi shqyrtimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe të dokumenteve mbështetëse. Gjatë këtij procesi, u identifikuan pyetje të rëndësishme lidhur me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të adresoheshin gjatë takimeve që do të zhvilloheshin në Institucionin e Arsimit të Lartë.

Vizita 2 ditore në Institucionin e Arsimit të Lartë Akademia "Nehemiah Gateway", u realizua gjatë datave 24-25.10.2024, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga ekspertet e ASCAL, të caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u prit nga Koordinatori Teknik, si edhe u takua me Dekanen e Fakultetit të Biznesit dhe Menaxhimit, si njësia kryesore dhe Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit si njësia bazë që ofron këtë program studimesh, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik efektiv dhe të angazhuar me kontratë në këtë program studimi, personelin nga Qendra për Kërkimin Shkencor; Komiteti i Kurrikulës dhe Menaxhimit të Cilësisë; Zyra e Burimeve Njerëzore; Sekretaria Mësimore; Zyra e Karrierës dhe Alumni), si dhe studentët e këtij programi studimi.

Gjatë kësaj vizite, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) realizoi vëzhgime të detajuara në mjediset dhe infrastrukturën që mbështesin zhvillimin e procesit mësimor të programit të studimit. Vëzhgimet përfshinë Sekretarinë Mësimore, bibliotekën, auditorët dhe mjediset e tjera që mbështesin aktivitete të ndryshme për studentët. Gjatë takimeve të zhvilluara, u diskutuan çështje të shumta që lidhen me

vlerësimin e programit të studimit, duke sqaruar edhe pikëpyetje që kishin lindur në lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzon raportin tek Kordinatori Teknik i ASCAL. Ky raport pasqyron vlerësimin e në lidhje me plotësimin e kitereve dhe standardeve që i referohen këtij program studimi bazuar në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL si dhe vizitës së realizuar në institucion.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway".**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Akademia Nehemiah Gateway është Institucion jo publik i Arsimit të Lartë (IAL) me financim privat, i cili ka filluar aktivitetin e tij akademik dhe shkencor në vitin 2008, licensuar me vendim nr.830, datë 4.6.2008 ''Për Licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë "SHKOLLA E LARTË "NEHEMIA", dhe riorganizuar me urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me Urdher Nr. 424, datë 14.07.2022, nga Shkolla e Lartë "Nehemiah Gateway" në Akademia "Nehemiah Gateway".<br><br>Akademia Nehemiah Gateway ka për mision të ofrojë edukim cilësor duke respektuar standarded kombëtare dhe ndërkombëtare, një model arsimi që ofron etikë dhe bazohet në kompetenca, në përputhje me nevojat e interesat e tregut lokal të zonës në të cilën IAL ka kampusin, si edhe nevojat vendase.<br><br>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Menaxhim" me profil në "Biznes" synon ruajtjen dhe forcimin e vlerave akademike e kulturore të vendit, duke u përqendruar në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit ku jetojnë si edhe rrjedhimisht të shoqërisë shqiptare. Për më tepër, Programi Master në "Menaxhim" me profil në "Biznes":<br>• Ndihmon në krijimin e një brezi të ri liderësh dhe menaxherësh të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit.<br>• Përçon vlerat kombëtare duke edukuar studentët me etikë profesionale dhe përgjegjshmëri sociale. |

| | |
|---|---|
| | • Mbështet inovacionin dhe zhvillimin e sektorit të biznesit, duke i përshtatur praktikat mësimore me kërkesat e kohës dhe duke forcuar lidhjet me komunitetin.<br><br>Programi fokusohet në ruajtjen e standardeve të larta akademike dhe në edukimin e studentëve me vlera të integritetit dhe profesionalizmit. Ai është ndërtuar në mënyrë që të ndërtojë ura bashkëpunimi mes traditës dhe inovacionit.<br><br>Programi respekton në tërësi ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Ai zbaton gjithashtu rregulloret e brendshme të IAL-së, duke garantuar që çdo aspekt i procesit akademik përputhet me vlerat dhe interesat kombëtare.<br><br>*Shtojca Nr. 2: Urdhër Nr.424 datë 1472022 Akademia Nehemiah Gateway*<br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademisë Nehemiah Gateway miratuar nga MAS.*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani strategjik.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i Studimit Master i Shkencave në "Menaxhim" me profil në "Biznes", i ofruar nga Akademia Nehemiah Gateway, është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e tij të veprimtarisë.<br><br>Përputhshmëria me Qëllimet dhe Misionin:<br>• Qëllimi i Edukimit Cilësor<br>• Etika dhe Kompetenca<br>• Inovacioni dhe Përgjegjësia Sociale<br><br>Përputhshmëria me Fushën e Veprimtarisë:<br>• Fokus në Menaxhim dhe Biznes<br>• Harmonizimi me Tregun<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademisë Nehemiah Gateway miratuar nga MAS.*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani strategjik.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi Master i shkencave në "Menaxhim" me profil në "Biznes":<br>• përfaqëson një shtyllë kryesore të strategjisë për zhvillim të akademisë, duke promovuar edukimin cilësor dhe përgatitjen e liderëve të ardhshëm në fushën e menaxhimit dhe biznesit.<br>• reflekton angazhimin e institucionit për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social, duke siguruar që të gjitha aktivitetet akademike të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të komunitetit dhe të tregut.<br>• respekton dispozitat e Statutit, duke u ndërtuar në bazë të vizionit dhe misionit të tij për të ofruar një model arsimor të bazuar në etikë dhe kompetenca profesionale.<br>• respekton rregulloret e brendshme të istitucionit, duke garantuar një proces akademik të rregullt dhe të standardizuar që përmbush kërkesat ligjore dhe institucionale.<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway miratuar nga MAS.*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani strategjik.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi i Studimit Master i Shkencave në "Menaxhim" me profil në "Biznes" ndërthur praktikat ndërkombëtare më të mira në kurrikulën e tij. Programi mbështetet në standarde dhe referenca ndërkombëtare si Korniza Evropiane e Kualifikimeve (EQF) dhe direktivat e arsimit të lartë të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademisë Nehemiah Gateway miratuar nga MAS.*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani strategjik.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia Nehemiah Gateway e ofron Programin e Studimit Master i Shkencave në "Menaxhim" me profil në "Biznes", në përputhje me misionin dhe qëllimin e saj duke ruajtur dhe respektuar interesat dhe vlerat kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të saj.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.2<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | GVJ konstaton se Programi Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes", ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway" mbështetet nga një personel akademik me përvojë të gjerë në fushën e menaxhimit dhe biznesit, duke përfshirë pedagogë vendas dhe ndërkombëtarë, me eksperiencë të pasur akademike dhe profesionale. Personeli akademik plotëson kriteret në përputhje me legjislacionin në fuqi sa i përket titujve akademik dhe gradave shkencore.<br><br>Programi është ndërtuar për të adresuar kërkesat bashkëkohore të menaxhimit të biznesit dhe për të kombinuar teorinë me praktikën, duke ofruar lëndë të rëndësishme për fushën e menaxhimit dhe biznesit, duke u siguruar studentëve njohuri dhe aftësi që janë jetike për zhvillimin e tyre profesional dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të punës.<br><br>Lëndët përfshijnë menaxhimi dhe lidershipi, menaxhimi strategjik, menaxhimi i riskut, menaxhimi i BNJ, menaxhimi i operacioneve, menaxhimi i cilësisë, menaxhimi i performances, sipërmarrja, etj. Për më tepër, kurrikula përfshin projekte praktike dhe studime të rasteve që reflektojnë sfidat e tregut lokal.<br><br>Kampusi universitar i lokalizuar në Pogradec ofron një mjedis studimi modern dhe mbështetës. Studentët kanë në dispozicion një bibliotekë të pasur dhe akses në burime digjitale. Gjithashtu, Akademia ofron mbështetje përmes këshillimit akademik dhe orientimit në karrierë, duke ndihmuar studentët të realizojnë potencialin e tyre maksimal. Një nga pikat e forta të këtij programi është lidhja e ngushtë me biznesin dhe komunitetin lokal. Akademia bashkëpunon me kompani dhe organizata vendase dhe ndërkombëtare për të siguruar mundësi për praktika. Kjo u |

| | |
|---|---|
| | mundëson studentëve të aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale dhe të ndërtojnë një rrjet profesional.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i përshkrimit të moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimeve në Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway", me kohëzgjatje 2 vite, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit në Fakultetin e Biznesit dhe Menaxhimit. Ky program studimi është miratuar me Urdhrin Nr.573, datë 03.10.2022, të Minstrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilin programi Master i Shkencave në ''Lidership dhe Vlerësim Arsimor'' u organizua në ''Menaxhim'' me profil në ''Biznes''. Ky riorganizim i programit erdhi si rrjedhojë e riorganizimit të IAL-së "Akademia Nehemiah Gateway", me Vendim Nr.424, date 14.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku fusha akademike u përqëndrua në Ekonomi dhe Menaxhim.<br><br>GVJ gjykon se ky program është hartuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin. Njësia kryesore përgjegjëse për këtë program ka ekspertizë të konsoliduar në fushat e menaxhimit dhe biznesit. Përmbajtja dhe struktura e programit janë në harmoni me profilin akademik të njësisë, duke pasqyruar drejtimet kryesore të saj në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Programi është klasifikuar dhe kodifikuar sipas sistemit të klasifikimit kombëtar dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë, duke respektuar direktivat kombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian. Bazuar në evidencat e paraqitura Akademia mori draft raportin nga MAS me kodifikimin e Programit të Studimit: 72MS0413A.<br><br>*Shtojca Nr. 1: Urdhër Nr.573 datë 3.10. 2022.Riorganizim Programi*<br>*Shtojca Nr. 2: Urdhër Nr.424 datë 1472022 Akademia Nehemiah Gateway*<br>*Shtojca Nr. 3: Draft-Raporti per kodifikimin e programeve te studimit, fusha 4 Nehemiah Gateway*<br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca Nr. 11: Katalogu i përshkrimit të moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Ashtu sic jemi shprehur edhe më sipër, GVJ gjykon se fushat e përgjithshme dhe specifike të programit janë të lidhura ngushtë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse.<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i përshkrimit të moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | NA |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion dhe pas vizitës në institucion konkludon se Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway" angazhohet të ofrojë trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar, në përgjigje të nevojave dhe kërkesave të tyre.<br>Përveç trajnimeve, Akademia u ofron studentëve të diplomuar këshillim për karrierën dhe ndihmë në përgatitjen për punësim, si dhe qasje në një rrjet profesional që ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të karrierës.<br><br>*Evidenca Nr. 18: Student Handbook*<br>*Evidenca Nr. 39: Regulation on Student Services Center*<br>*Evidenca Nr. 40: Alumni Survey Master Template* |
| **Konkluzione** | *GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara gjykon se programi i studimit Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway",* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. IAL Akademia NG demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Bazuar në evidencat e paraqitura, GVJ gjykon se Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway" ndjek një qasje të mirëorganizuar dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar një bashkëpunim efektiv brenda strukturave të tij, duke mbështetur hartimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e suksesshëm të programit të studimit. Personeli ka detyra dhe role të qarta. Akademia ka bashkëpunim të brendshëm me fondacionin NG Albania.<br><br>Akademia kryen procedura të brendshme dhe të jashtme vlerësimi. Sa i takon vlerësimit të brendshëm metodologjia e përdorur bazohet në instrumeta matëse të drejtëpërdreja dhe jo të drejtëpërdrejta, cilësore dhe sasiore. Puna e strukturave të akademisë analizohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme. Subjekte vlerësimi janë personeli akademik me kohë të plotë dhe personeli i ftuar, strukturat drejtuese si rektori, bordi i administrimit, administratori, si edhe personeli i administrates. Objekt vlerësimi i vazhdueshëm janë gjithashtu programet e studimit, shërbimet e ofruara, politikat dhe publikimet, veprimtaria financiare, dhe infrastruktura.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me | Bazuar statutit dhe planit strategjik 2020-2025, për të arritur objektivat e procesit mësimor dhe formues të studentëve, Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway" synon të krijojë dhe të zhvillojë marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të sektorit të biznesit, si vendës ashtu edhe ndërkombëtarë. Disa prej |

| | |
|---|---|
| institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | bashkëpunimeve janë vendosur me Akademinë Evropiane të Berlinit, Shkollën për teknologji të informacionit dhe biznes në Oldengurg, Universitetin SHR Berlin, Universiteti Fan S Nolin ë Korçë, Universitetin Aleksandër Xhuvani në Elbasan, etj.<br><br>Në raport me numrin aktual të studentëve që ndjekin studimet në "Akademia Nehemiah Gateway", numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit mund të konsiderohet i përshtatshëm. ***Megjithatë, GVJ gjykon se është e rëndësishme që institucioni të adoptojë një vizion strategjik për zgjerimin e këtyre marrëdhënieve dhe rritjen e numrit të studentëve në vitet e ardhshme.***<br><br>Gjithashtu, është e domosdoshme që numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të zgjerohet më tej, duke përfshirë partneritete të reja me institucione homologe dhe aktorë të tjerë relevantë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. ***Veçanërisht, rekomandohet që institucioni të përqendrohet në nismën për t'u bërë pjesë e programit Erasmus+, i cili do të mundësonte shkëmbimin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit, si dhe zgjerimin e mundësive për projekte të përbashkëta në fushën e arsimit dhe kërkimit.***<br><br>Ky angazhim do të ndihmojë në rritjen e profilit ndërkombëtar të institucionit, përmirësimin e përvojës së studentëve dhe zgjerimin e aksesit në burime dhe përvoja të reja, duke kontribuar kështu në përmbushjen e vizionit afatgjatë të tij.<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Evidenca Nr. 08: Cooperation Agreements*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani Strategjik* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo | Në kuadër të programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në Biznes, gjatë semestrit të katërt, përveç punimit të tezës së masterit, studentët kryejnë praktikën profesionale, e cila është e integruar në planin akademik dhe vlerësohet me 5 kredite ECTS. Ky komponent i programit synon të zhvillojë më tej aftësitë praktike dhe njohuritë e studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës.<br><br>Për realizimin e kësaj praktike, "Akademia Nehemiah Gateway" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me: adidas AG |

| | |
|---|---|
| stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | Herzogenaurach në Gjermani, cip GmbH Herzogenaurach në Gjermani, German-Albanian Business Association Berlin, Herm. Fichtner Hof GmbH, Jomos Schuhe, Müller Fotosatz & Druck, Tempus Consulting, Gärtnerei van Oordt, Beck International Recruitment, Dija Print Shop, Tirana Business Park, Bashkia Pogradec, etj. ***GVJ rekomandon që Akademia Nehemiah Gateway të zgjerojë bashkëpunimet me biznese vendase dhe lokale të zonës së Pogradecit dhe zonave përreth.***<br><br>*Evidenca Nr. 05: Raporti i vleresimit te brendshem periodik_Programi M.Sc. Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Departamenti i Menaxhimit në Akademinë Nehemiah Gateway zhvillon mbledhje periodike me qëllim diskutimin e projekteve aktuale dhe planifikimin e bashkëpunimeve të reja. Gjatë këtyre mbledhjeve, stafi akademik shqyrton mundësitë për realizimin e projekteve kërkimore të përbashkëta, përmirësimin e cilësisë së praktikave profesionale për studentët dhe thellimin e bashkëpunimeve me aktorë lokalë dhe ndërkombëtarë. Bazuar evidencave në dispozicion Akademia Nehemiah Gateway përgatit raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tyre akademike dhe shkencore.<br><br>Po ashtu, Akademia Nehemiah Gateway organizon anketa dhe intervista me bizneset dhe institucionet partnere për të vlerësuar performancën e studentëve gjatë praktikave profesionale.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Shtojca Nr. 12: Raporti vjetor i Akademisë "Nehemiah Gateway" viti akademik 2022 – 2023*<br>*Evidenca Nr. 09: Guide on Internship for M.Sc.program* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se marrëdhëniet e bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional janë mjaft të rëndësishme për Akademinë Nehemiah Gateway. Në raport me numrin aktual të studentëve që ndjekin studimet në "Akademia Nehemiah Gateway", numri i bashkëpunimeve mund të konsiderohet i përshtatshëm.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |





| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" i ofruar nga Akademia Nehemiah Gateway, realizohet gjatë një periudhe prej dy vitesh akademike, duke përfshirë gjithsej 120 kredite ECTS. Ky program është i strukturuar në katër semestra akademike dhe zhvillohet në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim, studentëve u lëshohet diploma "Master i Shkencave" në "Menaxhim", me profil në "Biznes, në përputhje me rregulloret dhe kurrikulën përkatëse të institucionit.<br><br>Programi përmban një përshkrim të plotë të strukturës akademike, duke respektuar kategorizimin e lëndëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Lëndët janë të ndara si më poshtë:<br><br>• Lëndë bazë (Kategoria A): Përqendrohen në ndërtimin e bazës teorike të studentëve dhe përbëjnë 10 kredite ECTS.<br>• Lëndë karakterizuese (Kategoria B): Përfshijnë njohuri të thelluara dhe specifike të programit, duke përbërë 60 kredite ECTS.<br>• Lëndë ndërdisiplinore/integruese (Kategoria C): Për të zhvilluar aftësi integruese dhe bashkëpunuese, me një total prej 15 kreditesh ECTS.<br>• Lëndë plotësuese (Kategoria D): Mbështesin zhvillimin e aftësive shtesë dhe përbëjnë 15 kredite ECTS.<br>• Detyrime përmbyllëse (Kategoria E): Përfshin realizimin e punimit të diplomës, i cili përbën 20 kredite ECTS. |
| | Sa më sipër GVJ vlerëson se elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në |

| | |
|---|---|
| | kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes*<br>*Shtojca Nr. 11. Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi "Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" synon të avancojë edukimin e drejtuesve dhe të zgjerojë aftësitë e tyre në fusha të ndryshme, duke i përgatitur ata për të qenë liderë më efektivë dhe të suksesshëm. Kurrikula është hartuar, zhvilluar dhe rishikuar me kujdes nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe si e tillë zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara. Ky program synon t'ju ofrojë studentëve formim teorik dhe praktik, ndaj ka të përfshira lëndë të fokusuara në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura më fushën e menaxhimit dhe biznesit.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes*<br>*Shtojca Nr. 11. Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi është dhe praktika profesionale/projkt hulumtues, e cila zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë dhe ka 5 kredite ECTS. Sa i takon detyrimeve përmbyllëse, punimit të diplomës, studentët kanë të përcaktuar ngarkesën në 20 kredite ECTS. Në dokumentin e rregullores së programit të studimit përcaktohen qartë parakushtet dhe kriteret e vlerësimit të temës së masterit.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, | **NA** |

| | |
|---|---|
| që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | **NA** |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | **NA** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi "Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" është i ngjashëm me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëve brenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes*<br>*Shtojca Nr. 11. Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes* |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Në kuadër të vendimit Nr. 310, Datë 11.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si edhe Udhëzimit Nr 31, Date 15 Nëntor 2022 "Për Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati akademik i Akademisë, ka përcaktuar kodin për programin në fjalë. Sipas draft raportit të MAS, më qershor 2024, është përcaktuar kodifikimi i programit 72MS0413A.<br><br>*Shtojca Nr. 3: Draft-Raporti per kodifikimin e programeve te studimit, fusha 4 Nehemiah Gateway* |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi "Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi të tillë, në formën e një program të përbashkë midis IAL-ve vendase apo të huaja, ndaj GVJ konstaton se ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi. |
| **Konkluzione** | *Programi "Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" përcakton qartë elementët që përbëjnë strukturën e tij, ka të përfshira lëndë të fokusuara në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura më fushën e menaxhimit dhe biznesit, përcakton qartë ngarkesën në kredite, ka përmbajtje të ngjashme me programe të tjera të të njëjtit cikël studimi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi II.2<br>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</td><td>Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Menaxhim”, me profil në “Biznes” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia Nehemiah Gateway”, me kohëzgjatje 2 vite, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit në Fakultetin e Biznesit dhe Menaxhimit. Ky program studimi është miratuar me Urdhrin Nr.573, datë 03.10.2022, të Minstrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilin programi Master i Shkencave në ‘‘Lidership dhe Vlerësim Arsimor’’ u organizua në ‘‘Menaxhim’’ me profil në ‘‘Biznes’’. Ky riorganizim i programit erdhi si rrjedhojë e riorganizimit të IAL-së “Akademia Nehemiah Gateway”, me Vendim Nr.424, date 14.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku fusha akademike u përqëndrua në Ekonomi dhe Menaxhim.<br><br>Bazuar Vendimit BA Nr. 73, datë 19.04.2024 Akademia NG është akredituar në nivel Institucional për 5 (pesë) vite, për periudhën 19/04/2024 deri në 18/04/2029), duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.<br><br>Njësia kryesore, Fakulteti i Biznesit dhe Menaxhimit është organizuar në 3 njësi bazë:<br>1. Departamenti i Menaxhimit;<br>2. Departamenti i Biznesit;<br>3. Qendra Kërkimore Shkencore;<br><br>Sa i takon personelit akademik në vijim përbërja e Personelit Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë.<br><br>
<table>
<tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof. Dr</td><td></td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof. As. Dr</td><td></td><td></td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>4</td><td>1</td><td>2</td><td>-</td></tr>
</table>
</td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Msc | 1 | | 2 | - |
| Në total | 5 | 2 | 5 | 1 |

Sa më sipër, Akademia NG ka nënshkruar një marrëveshje me MAS, nr prot 4806/1, datë 26.07.2023, ''Mbi përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë në njësinë bazë, në Akademinë NG'', në të cilën përcaktohet numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë që do të kenë në përbërje njësitë bazë të akademisë, si edhe numri minimal i personelit akademik që duhet të ketë gradë shkencore ose tituj akademik. Sipas nenit 3, pika 1, përcaktohet se nëse Akademia NG për të paktën 3 vite akademike nuk ka më shumë se treqqind studentë dhe përmbush kushtet e kodit të cilësisë të procesit mësimor, mund të mos plotësojë kushtin e përcaktuar në pikën 4, të nenit 25, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Sipas nenit 3, pika 2,të marrëveshjes, me nr prot 4806/1, datë 26.07.2023, ''Mbi përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë në njësinë bazë, në Akademinë NG'', midis MAS dhe Akademisë, përcaktohet se Departamenti i Menaxhimit, Departamenti i Biznesit dhe Qendra Kërkimore Shkencore, që janë njësi bazë të Fakultetit të Biznesit dhe Menaxhimit, do të kenë të paktën 4 anëtarë të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën dy të kenë gradë shkencore ose tituj akademik.

*Shtojca Nr. 1: Urdhër Nr.573 datë 3.10. 2022.Riorganizim Programi*

*Shtojca Nr. 2: Urdhër Nr.424 datë 1472022 Akademia Nehemiah Gateway*

*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*

| | |
|---|---|
| | https://www.ascal.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout<br>=item&id=81&Itemid=698&lang=sq |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Fakulteti i Biznesit dhe Menaxhimit si edhe Departamenti i Menaxhimit bashkëpunojnë ngushtë me strukturat ndihmëse akademike dhe administrative për të siguruar realizimin me sukses të praktikës mësimore. Zyra e Karrierës dhe Zyra e Alumnit angazhohet nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Sipas dokumenteve të brendshme të institucionit, roli i koordinatorit të programit të studimit i është deleguar përgjegjësit të departamentit, i cili mbikëqyr ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e përcaktuara.<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Evidenca Nr. 07: Catalog of HEI Nehemiah Gateway*<br>*Evidenca Nr 19: Academic Regulation_HEI Nehemiah Gateway*<br>*Evidenca Nr. 20: Faculty Handbook* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Fakulteti i Biznesit dhe Menaxhimit si edhe Departamenti i Menaxhimit bashkëpunojnë ngushtë me strukturat ndihmëse akademike dhe administrative për të siguruar realizimin me sukses të praktikës mësimore. Po ashtu institucioni ka marrë masat që studentët të kenë coordinator program.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| |
|---|
| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Njësia kryesore dhe njësia bazë, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, janë të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me statutin dhe rregulloret e përgjithshme të institucionit. Këto njësi kanë të përcaktuara qartë në aktet normative detyrat, përgjegjësitë dhe funksionet e tyre, duke përfshirë edhe menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve akademike dhe administrative të programit të studimit.<br><br>Për sa i përket organizimit, strukturës dhe përmbajtjes së programit të studimit, këto njësi zotërojnë të gjitha informacionet e nevojshme dhe sigurojnë mbështetjen e vazhdueshme për zbatimin e standardeve akademike dhe administrative. Ky proces realizohet nëpërmjet një qasjeje të mirëkoordinuar ndërmjet njësive përkatëse, duke përfshirë planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të programit, në mënyrë që të garantohet cilësia dhe përputhshmëria me kornizën kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Evidenca Nr. 07: Catalog of HEI Nehemiah Gateway*<br>*Evidenca Nr 19: Academic Regulation_HEI Nehemiah Gateway*<br>*Evidenca Nr. 20: Faculty Handbook* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i studimit përmban planin mësimor të hartuar në përputhje me kurrikulën e miratuar dhe standardet përkatëse akademike. Në këtë plan mësimor përfshihet informacioni i detajuar për ndarjen e lëndëve/moduleve sipas semestrave, ECTS, ngarkesën mësimore të secilës lëndë/module (orë kontakti, orë studimi i pavarur). Po ashtu, katalogu i përshkrimit të moduleve ofron informacion të detajuar dhe specifik për secilën lëndë/module të përfshirë në programin e studimit. Ky katalog përmban të dhëna si objektivat e mësimit, përmbajtjen kryesore/temat, literaturën e rekomanduar, metodologjitë e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe kreditet e alokuara sipas sistemit ECTS, të dhëna mbi lektorin dhe kontaktet e tij.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme | GVJ konstaton se rregullorja e Programit të Studimeve Master i Shkencave në "Menaxhim", me profil në "Biznes" përmban qartë dhe në mënyrë të detajuar të gjitha informacionet e nevojshme për |

| | |
|---|---|
| për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | studentët. Këto përfshijnë kriteret specifike të pranimit, strukturën e programit të studimit, objektivat akademike, ngarkesën me kredite, sistemin e vlerësimit, si dhe procedurat për transferimin dhe ekuivalentimin e lëndëve.<br><br>Ky informacion është i aksesueshëm për studentët që në momentin e regjistrimit dhe vazhdon të ofrohet në mënyrë të rregullt nga strukturat akademike dhe administrative të institucionit, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të studimeve.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit siguron informacion të plotë për secilën lëndë, duke përfshirë numrin e orëve akademike, shpërndarjen e tyre në leksione dhe seminare, orët e punës individuale të studentëve, numrin e krediteve ECTS, si dhe vitin dhe semestrin akademik në të cilin zhvillohen.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, në bashkëpunim me Komisionin e Kurrikulës, shqyrton dhe diskuton në mbledhjet e saj përmirësimet e programeve të lëndëve, duke u fokusuar veçanërisht në literaturën që do të përdoret. Gjithashtu, çdo vit realizohet një rishikim dhe përditësim i syllabuseve për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë me standardet bashkëkohore. GVJ sugjeron se Lënda bazë "Hulumtim dhe Shkrim Akademik" mund të riemërtohet si "Shkrim Akademik," duke qenë se ekziston një lëndë tjetër e dedikuar posaçërisht për hulumtimin dhe metodat e tij. Kjo ndarje lejon fokusimin specifik në zhvillimin e aftësive të shkrimit akademik, ndërsa aspektet e hulumtimit trajtohen në mënyrë të veçantë në lëndën përkatëse.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Ai ofron informacion të plotë dhe të aksesueshëm për studentët, duke mbuluar të gjitha aspektet akademike dhe administrative të nevojshme. Programi mbështet formimin e studentëve me një qasje gjithëpërfshirëse dhe metodologji të përshtatura për përmbushjen e objektivave të tij.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim”, me profil në “Biznes” janë plotësisht të harmonizuara me fushën e studimit që mbulon programi. Ky program u ofron studentëve mundësinë për të zgjeruar dhe thelluar njohuritë e tyre përmes lëndëve të strukturuara dhe literaturës bashkëkohore. Përmbajtja e kurrikulës është konceptuar për të ofruar njohuri bazë dhe të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit dhe është në linjë me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në rregulloren e programit.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Struktura e lëndëve/moduleve, shpërndarja semestrale, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore sigurojnë përmbushjen e objektivave formues të programit dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të | Programi i studimit është ndërtuar mbi një strukturë të organizuar që siguron një progresion logjik të lëndëve dhe aktiviteteve, duke u mundësuar studentëve arritjen e qëllimeve të tyre akademike dhe profesionale. Përmes një game të larmishme lëndësh, programi |

| | |
|---|---|
| studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | mbështet zhvillimin e njohurive dhe aftësive, duke ofruar një kombinim të ekuilibruar ndërmjet teorisë dhe praktikës. Gjatë vizitës në institucion u theksua se programi është hartuar duke u bazuar në praktika ndërkombëtare dhe literaturë të huaj, duke u orientuar drejt standardeve të njohura ndërkombëtarisht.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Ky program garanton njohuri themelore dhe të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit, me lëndë të strukturuara sipas kategorive të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Raporti ndërmjet lëndëve teorike dhe atyre praktike është konceptuar për të përmbushur objektivat e programit dhe për të përgatitur studentët për sfidat e tregut të punës. Bazuar Kurrikulës saë programit të studimit Kategoria e A, e lëndëve (Lëndë Bazë) zë 8 %, Kategoria B Lëndë karakterizuese 50%, Kategoria C Lëndë ndërdisiplinore/integruese 12.5%, Kategoria D Lëndë Plotësuese 12.5% dhe Kategoria E Detyrime Përmbyllëse 17 %.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi siguron që programet e lëndëve të jenë në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e menaxhimit dhe biznesit, duke kryer rishikime dhe përditësime të vazhdueshme. Gjatë takimit në institucion sikurse është përmendur edhe më sipër, shqyrtohen dhe diskutohen përmirësimet e mundshme të programit për ta përshtatur atë me kërkesat e tregut të punës dhe risitë bashkëkohore në këtë fushë. Literatura e përdorur përfshin tekste bazë të detyrueshme dhe materiale ndihmëse, duke siguruar një mbështetje të plotë për procesin e të nxënit.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani strategjik* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton | Ky program studimi ofron mundësinë për studentët të fitojnë një bazë të gjerë dhe të thelluar njohurish në fushën e menaxhimit dhe biznesit. Stafi akademik i përfshirë në këtë program përdor |

| | |
|---|---|
| përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | metodologji të përshtatshme duke siguruar që studentët të përvetësojnë njohuri akademike dhe shkencore në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Ashtu sic jemi shprehur edhe më sipër kjo gjë arrihet përmes një game të larmishme lëndësh.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Menaxhim" me profil në "Biznes" u mundëson të diplomuarve të vazhdojnë studimet në ciklin e tretë akademik dhe i përgatit ata për të qenë konkurrues në tregun e punës. Të diplomuarit mund të angazhohen në profesione të ndryshme, duke përfshirë:<br>• Menaxher në organizata private dhe publike<br>• Këshilltar biznesi dhe menaxhimi<br>• Analist i proceseve të biznesit<br>• Drejtues projektesh dhe zhvillimi<br>• Sipërmarrës ose drejtues të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme<br>Ky program ofron një kombinim të njohurive teorike dhe praktike, duke i pajisur studentët me kompetencat e nevojshme për karrierë profesionale dhe akademike.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Konkluzione** | *GVJ arrin në përfundimin se struktura dhe organizimi i programit të studimit janë të harmonizuara me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Kuadri Kombëtar dhe Evropian i Kualifikimeve, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kompetencat që përputhen me kërkesat e tregut të punës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5** |
|---|

| Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Stafi akademik i këtij programi përpiqet vazhdimisht të azhurnojë dhe të përmirësojë përmbajtjen e lëndëve, duke reflektuar zhvillimet më të reja në fushën e menaxhimit dhe biznesit. Për të mbledhur informacion mbi kërkesat e tregut të punës, realizohet analiza e tij, ndërsa një hulumtim i detajuar mbi nevojat e tregut kryhet çdo tre vjet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me drejtuesin e menaxhimit të cilësisë.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Evidenca Nr. 42: M.Sc. Program review 15-20* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion, takimin në IAL, konstaton se Akademia NG angazhon studentët dhe strukturat e tyre në procesin e vlerësimit të programit të studimit përmes sondazheve të organizuara me studentët aktualë, ata të rinj dhe të diplomuarit. Një sondazh i veçantë për alumni realizohet dy vite pas diplomimit dhe përsëritet çdo dy vite, duke mbledhur sugjerime për përmirësimin e programit.<br><br>Studentët gjithashtu vlerësojnë cilësinë e lektorëve dhe lëndëve përmes formularëve të posaçëm të vlerësimit. Formulari për vlerësimin e moduleve (FO) plotësohet nga studentët pas përfundimit të çdo lënde, dhe rezultatet analizohen nga drejtuesi i menaxhimit të cilësisë, i cili i përcjell ato fakultetit për veprime të mëtejshme.<br><br>Për më tepër, vlerësimi i performancës dhe planifikimit të lektorëve realizohet çdo vit përmes formularëve të posaçëm, ndërsa vlerësimi PEP kryhet nga administratori dhe rektori. Këto procese sigurojnë që opinioni i studentëve dhe i të diplomuarve të përfshihet aktivisht në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Dokument Nr. 05: Raporti i vleresimit te brendshem periodik_Programi M.Sc. Menaxhim me profil ne Biznes.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Njësia bazë luan një rol aktiv në përmirësimin e programit të studimit duke organizuar konsultime që shërbejnë për të siguruar që programi i studimit të reflektojë nevojat dhe tendencat aktuale të tregut. Për të mbledhur informacion mbi kërkesat e tregut të punës, realizohet analiza e tij, ndërsa një hulumtim i detajuar mbi nevojat e tregut kryhet çdo tre vjet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me drejtuesin e menaxhimit të cilësisë.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Dokument Nr. 05: Raporti i vleresimit te brendshem periodik_Programi M.Sc. Menaxhim me profil ne Biznes.*<br>*Evidenca Nr. 42: M.Sc. Program review 15-20* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia NG promovon një proces gjithëpërfshirës për hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, duke angazhuar studentët, alumni, strukturat e tyre dhe bashkëpunëtorët kryesorë. Përmes sondazheve të rregullta me studentët aktualë, të diplomuarit dhe alumni, si dhe analizave të tregut të punës, institucioni siguron që programi të reflektojë nevojat dhe tendencat më të fundit të tregut. Proceset e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, përfshirë vlerësimet e moduleve, lektorëve dhe performancës së përgjithshme, kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative. Kjo qasje e koordinuar garanton përmbushjen e objektivave të programit dhe përshtatjen e tij me standardet bashkëkohore dhe kërkesat profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Kurrikula e këtij programi studimi është përshtatur me objektivat bazë strategjike të institucionit, të cilat lidhen dhe me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. Pjesë e veprimtarive mësimore është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës. |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Dokument Nr. 05: Raporti i vleresimit te brendshem periodik_Programi M.Sc. Menaxhim me profil ne Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 15: EO_Rregullore per funksionimin e Qendres Kerkimore-Shkencore.* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Statuti i Akademisë Nehemiah Gateway përcakton qartë rregullat e organizimit dhe funksionimit të strukturave përbërëse, veprimtaritë e autoriteteve dhe të organeve drejtuese, si dhe detyrat dhe të drejtat e personelit akademik. Këto dispozita garantojnë autonominë universitare dhe lirinë akademike.<br><br>Njësia bazë për këtë program studimi, mundëson për stafin kademik dhe administrativ që angazhohet në këtë program, bashkëpunim në funksion të procesit akademik-shkencor, mundëson një mjedis akademik të hapur dhe krijues duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik.<br><br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | GVJ konstaton se Akademia Nehemiah Gateway inkurajon studentët të angazhohen në trajnime dhe projekte të ndryshme. Në këtë drejtim, institucioni ofron një bibliotekë të pasur me libra të shtypur dhe elektronikë, si dhe abonime në revista shkencore. Po ashtu institucioni mbështet financiarisht kërkimin shkencor. ***Rekomandohet që të zhvillohen më shumë iniciativa dhe të zgjerohet spektri i aktiviteteve për të përfshirë studentët në studime apo projekte kërkimore shkencore.*** |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Bazuar në rregulloren e brendshme për funksionimin e njësisë bazë të Qendrës Kërkimore Shkencore dhe publikimeve akademike të Akademisë Nehemiah Gateway aktiviteti kërkimor mbështetet financiarisht si nga buxheti i akademisë, ashtu edhe nga donatorë të jashtëm. Financimi realizohet në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara nga fondi kërkimor shkencor.<br><br>Bazuar në rregulloren e brendshme për funksionimin e njësisë bazë të Qendrës Kërkimore Shkencore dhe publikimeve akademike të Akademisë Nehemiah Gateway, neni 10 mbi financimin e kërkimit |

| | |
|---|---|
| | shkencor dhe bazuar referencës në këtë dokument lidhur me kërkimin shkencor, për të zhvilluar punën kërkimore dhe aktivitetet e veta për vitin 2022, në buxhetin e saj, Akademia Nehemiah Gateway ka parashikuar 5% të buxhetit total të Akademisë; ndërsa buxheti për kërkimin shkencor përbën 2.6% të buxhetit total të Akademisë. Buxheti i Qendrës së Kërkimit Shkencor hartohet nga Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore, propozohet në Senatin Akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit. Në buxhetin e kërkimit shkencor për 2022 janë llogaritur: kërkime shkencore dhe publikime 335,500 lekë; seminare dhe trajnime 146,400 lekë; kualifikime dhe konferenca 427,000 lekë dhe udhëtimi studimor 890,600 lekë.<br><br>*Shtojca Nr. 15: EO_Rregullore per funksionimin e Qendres Kerkimore-Shkencor*<br>*https://www.ng-university.org/al/kerkimi/fondi-i-kerkimit-shkencor* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se programi i studimit ofron një orientim të mirë në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Njësia bazë për këtë program studimi, mundëson bashkëpunim në funksion të procesit akademik-shkencor dhe një mjedis akademik të hapur dhe krijues duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Sugjerohet të nxitet një angazhim më i madh i studentëve në aktivitete shkencore. Sa i takon mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, IAL bazuar dhe në numrin e personelit akademik që ka e ofron këtë mbështetje. Gjithsesi rekomandohet që në vijim buxheti të rritet për të inkurajuar personelin në rritjen e angazhimit në veprimtari shkencore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron | GVJ në bazë të dokumentacionit mbështetës dhe vizitës në IAL konstaton se ekziston bashkëpunim midis strukturave dhe dhe një angazhim i dukshëm për të mbështetur kërkimin shkencor. Vërehet dëshira, iniciativa dhe vullneti për të avancuar në këtë drejtim. |

| | |
|---|---|
| bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Rekomandohet angazhim më i madh për të realizuar projekte kërkimore shkencore dhe për të siguruar fonde të qëndrueshme përmes projekteve, duke përmirësuar kështu rezultatet dhe ndikimin e kërkimit shkencor.<br><br>*Shtojca Nr. 12_Raporti vjetor i Akademisë "Nehemiah Gateway" viti akademik 2022 – 2023*<br>*Shtojca Nr. 15: EO_Rregullore per funksionimin e Qendres Kerkimore-Shkencore_al*<br>*Evidenca Nr. 08: Cooperation Agreements*<br>*Evidenca Nr. 16: DAAD Conference documentation* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Njësia bazë inkurajon dhe angazhon studentët në veprimtari kërkimore. Rekomandohet që ky angazhim të zgjerohet duke përfshirë studentët në një numër më të madh studimesh dhe projektesh kërkimore. Po ashtu, njësia angazhohet për të përmbushur kërkesat për studime dhe projekte, duke vënë në dispozicion ekspertizën e personelit akademik për të arritur objektivat e parashikuara.<br><br>*Shtojca Nr. 12_Raporti vjetor i Akademisë "Nehemiah Gateway" viti akademik 2022 – 2023*<br>*Shtojca Nr. 15: EO_Rregullore per funksionimin e Qendres Kerkimore-Shkencore_al*<br>*Evidenca Nr. 08: Cooperation Agreements*<br>*Evidenca Nr. 16: DAAD Conference documentation* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | GVJ konstaton se, në bashkëpunim me universitetet partnere SRH në Gjermani dhe Universitetin "Ss. Cyril and Methodius" në Shkup, janë organizuar 3 konferenca të përbashkëta, duke qenë pjesë e programit "Dialog Universitar" me vendet e Ballkanit Perëndimor, i financuar nga DAAD. Ky bashkëpunim kontribuon në forcimin e lidhjeve akademike dhe shkencore ndërmjet universiteteve të rajonit dhe ofron mundësi të reja për zhvillimin e kërkimit dhe shkëmbimin e ekspertizës.<br><br>*Shtojca Nr. 12_Raporti vjetor i Akademisë "Nehemiah Gateway" viti akademik 2022 – 2023* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon | Bazuar kurriklues së programit të studimit si edhe bazuar programeve të ngjashme ndërkombëtare GVJ konstaton se programi |

| | |
|---|---|
| profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | i studimit përmban lëndët e përshtatshme dhe të strukturuara që i ofrojnë studentëve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të u formuar si profesionistë konkurrues për tregun e punës, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Ai është dizajnuar për të përmbushur kërkesat e zhvillimeve të tregut dhe për t'i përgatitur studentët për mundësi të ndryshme karriere.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | **NA** |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | **NA** |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara. Ndërkohë nevojitet më shumë angazhim në përfshirjen e studentëve në studime dhe projekte kërkimore, po ashtu rekomandohet të zhvillohen më shumë veprimtari në këtë kuadër.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Rregullorja e Programit "Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" përcakton qartë format e mësimdhënies dhe objektivat e procesit akademik. Ndër format kryesore të mësimdhënies përfshihen leksionet dhe seminaret.<br><br>Këto forma janë të integruara me procesin e të nxënit, duke u ofruar studentëve mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre përmes detyrave të kursit, projekteve, raste studimi, prezantime, raporte, simulime, provimeve dhe diskutimeve akademike në auditor.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si edhe bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi siguron angazhimin aktiv të studentëve gjatë procesit mësimor, duke përdorur metoda interactive (Case study, diksutime, debate, pune grupi, simulime) dhe duke nxitur mendimin kritik. Grupet e përbëra nga numra të vogël studentësh kanë bërë të mundur ofrimin e një vëmendje dhe dedikimi më të madh drejtuar atyre.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Shtojca Nr. 10: Kurikula Menaxhim me profil Biznesi*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu I pershkrimit te moduleve-menaxhim me profil Biznesi* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe | Institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit akademik duke ofruar trajnime të vazhdueshme për përmirësimin e kompetencave didaktike. Këto trajnime përqendrohen në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, përfshirë |

| | |
|---|---|
| në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | teknikat interaktive dhe teknologjitë e dixhitalizuara, me qëllim përshtatjen ndaj kërkesave të kohës dhe përmbushjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. Përmes kësaj mbështetjeje, institucioni siguron një proces akademik cilësor dhe të orientuar drejt studentëve.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Shtojca Nr. 17: Plani strategjik*<br>*Dokument Nr. 05: Raporti i vleresimit te brendshem periodik_Programi M.Sc. Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Shtojca Nr. 12: Raporti vjetor I akademise "Nehemiah Gateway" viti akadmeik 2022-2023.pdf* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Institucioni i Arsimit të Lartë Akademia NG e konsideron prioritet angazhimin e stafit akademik me kualifikime të larta metodike dhe ekspertizë në fushën përkatëse. Personeli i ftuar është kontraktuar nga universitete ndërkombëtare. Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit bashkëpunon ngushtë me strukturat drejtuese dhe me njëri-tjetrin për të ndarë përvoja dhe praktika akademike.<br><br>*Evidenca Nr. 19: Academic Regulation_HEI Nehemiah Gateway.*<br>*Evidenca Nr. 20: Faculty Handbook*<br>*Dokument Nr. 05: Raporti i vleresimit te brendshem periodik_Programi M.Sc. Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | GVJ gjykon se institucioni ka zhvilluar mekanizma dhe instrumente efektive për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të lëndëve dhe programit të studimit në tërësi. Ky proces realizohet përmes pyetësorëve të standardizuar, të rregullta dhe mjeteve të tjera të vlerësimit, që synojnë të identifikojnë dhe adresojnë nevojat dhe pritshmëritë akademike në mënyrë sistematike. Pas çdo moduli realizohen pyetësorët. Këta pyetësor zhvillohen online dhe dërgohen përmes sistemit të brendshëm elektronik 'populi' nga sekretaria. Mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre realizohet përmes një procesi të kujdesshëm.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Evidenca Nr. 06: Assessment Plan of HEU Nehemiah Gateway*<br>*Evidenca Nr. 14_FO Module Evaluation Form* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Krahas pyetësorëve të realizuar për të vlerësuar performancën e lektorëve, zhvillohen edhe fokus grupe me lektorët të organizuara nga Rektori.<br><br>Akademia NG ka integruar përmirësimin e vazhdueshëm të procesit akademik si një element kyç të strategjisë së tij, duke përfshirë të gjitha strukturat akademike, ndihmëse dhe administrative në këtë proces.<br><br>Strategjia e institucionit mbështetet në zhvillimin e procesit akademik dhe kërkimit shkencor. Për këtë qëllim, stafi akademik trajnohet rregullisht për të përmirësuar metodologjitë e mësimdhënies dhe për të zbatuar teknika inovative të përshtatura për secilin program studimi.<br><br>Bashkëpunimi ndërmjet njësive të ndryshme është i rregulluar dhe i formalizuar në aktet normative të institucionit, duke siguruar një qasje të integruar dhe të koordinuar për realizimin e objektivave akademike dhe kërkimore.<br><br>*Shtojca Nr. 6: Rregullore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë*<br>*Shtojca Nr. 5: Statuti i Akademise Nehemiah Gateway_miratuar nga MAS*<br>*Evidenca Nr. 06: Assessment Plan of HEU Nehemiah Gateway*<br>*Evidenca Nr. 14_FO Module Evaluation Form*<br>*Evidenca Nr. 13: PEP Evaluation Form* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe gjatë vititës në IAL, gjykon se Akademia NG garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të | Institucioni siguron transparencë dhe qartësi në lidhje me kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive |

| | |
|---|---|
| njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | profesionale dhe shkencore. Këto janë të përcaktuara në rregulloren akademike, rregulloren e programit, katalogun e akademiksë dhe katalogun e studentëve. Dokumentet përkatëse janë të publikuara dhe të aksesueshme për studentët, duke garantuar që ata të jenë të mirëinformuar dhe të njohur me procedurat dhe pritshmëritë e vlerësimit gjatë gjithë procesit të studimit.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të çdo lënde/moduli, titullari i lëndës/modulit informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, sipas përcaktimeve të detajuara në syllabuset/rregulloret përkatëse. Ky proces garanton që studentët të jenë të qartë mbi kriteret dhe pritshmëritë që lidhen me vlerësimin, duke i ndihmuar ata të planifikojnë dhe të angazhohen në mënyrë efektive gjatë procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Këto të dhëna janë të aksesueshme edhe përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm Populi, dhe në website.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Sistemi i vlerësimit është paraqitur qartësisht në rregulloret e institucionit të cilat i vihen në dispozicion studentëve fizikisht, online përmes website dhe sistrmit të brendshëm. Testimi realizohet përmes disa formave si:<br>o Provim me shkrim/gojë<br>o Prezantim<br>o Detyrë kursi<br>o Project kërkimor dhe prezantim<br>o Teza,<br>o etj.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |





| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ bazuar në evidencat në dispozicion gjykon se Akademia NG harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe garanton zbatimin e tyre.Institucioni siguron transparencë dhe qartësi në lidhje me kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore. Sistemi i vlerësimit është paraqitur qartësisht në rregulloret e institucionit të cilat i vihen në dispozicion studentëve fizikisht, online përmes website dhe sistrmit të brendshëm.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Institucioni ka të përcaktuara qartë procedurat dhe kalendarin e provimeve/vlerësimit të dijeve të studentëve përmes rregullores së programit të studimit, si dhe vendimeve dhe udhëzimeve përkatëse. Këto akte të brendshme janë të standardizuara në nivel institucional dhe të njohura për stafin akademik dhe studentët.<br><br>Lektori teston studentët në përputhje me format e vlerësimit të përcaktuara në Katalogun e përshkrimit të moduleve. Çdo form tjetër duhet të miratohet nga Dekani.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Procesi i kontrollit të dijeve dhe vlerësimi i tyre është një proces që siguron anonimatin dhe transparencën. Në sistemin e brendshëm Populi (i cili është funksional dhe përdoret në këtë institucion) lektorët mund të krijojnë provime, të cilat po ashtu realizohen në këtë platformë online, dhe nëse teza përfshin pyetje me alternativa, nota përcaktohet nga Populi. |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është përgjegjës për vlerësimin e studentëve në përputhje me komponentët e miratuara në syllabus-et e lëndëve përkatëse. Metodat e vlerësimit të dijeve dhe kontrollit të aftësive janë të përcaktuara dhe bëhen të njohura për studentët në fillim të çdo semestri akademik, përmes informacioneve që ofrohen nga syllabus-et e lëndëve dhe komunikimit direkt me pedagogët dhe përmes website/Populi. Kjo siguron transparencë dhe kuptim të qartë të procedurave dhe pritshmërive për studentët gjatë procesit mësimor.<br><br>Vlen të theksohet se detyrat dhe esetë kanë vlerësim më të lartë krahasimisht me pjesëmarrjen në klasë/prezantimet, kjo për ti orientuar studentët drejt mendimit kritik, shkrimit dhe hulumtimit akademik.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Personeli akademik informon studentët për vlerësimet përkatëse. Studentët mund të kërkojnë një kopje të komenteve të shkruara nga vlerësuesi.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Studentët janë të detyruar të nënshkruajnë dhe respektojnë Kodin e Nderit, duke u angazhuar për të ruajtur standardet etike dhe akademike. Politikat kundër kopjimit dhe plagjiaturës janë të rrepta dhe çdo shkelje e këtyre politikave mund të rezultojë në ndëshkimin e studentit, deri në përjashtimin e tij nga programi. |

| | |
|---|---|
| | Për të nxitur integritetin akademik, studentët inkurajohen të përdorin software të bibliografisë dhe citimit, me rekomandim të veçantë për përdorimin e Bibliografisë Citavi. Kjo metodë siguron përputhshmërinë me praktikat e mirëfillta akademike dhe mbështet kërkesat për citim të saktë dhe të përgjegjshëm. Citavi është një program për menaxhimin e referencave dhe organizimin e njohurive. Ai ofron funksionalitete për krijimin e referencave, shënimin dhe etiketimin e dokumenteve PDF, menaxhimin e detyrave, analizimin e burimeve dhe lidhjen e ideve, si dhe ndihmon në procesin e shkrimit dhe menaxhimit të citimeve. Citavi ofron një version provë falas për 30 ditë, i cili mund të shkarkohet nga faqja zyrtare.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e kontrollit të dijeve në këtë program studimi bazohen në meritë dhe janë transparente. Ato jepen në kohë, në përputhje me përcaktimet dhe afatet e vendosura në rregulloret përkatëse të institucionit. Ky proces siguron që studentët të marrin vlerësimin e merituar për përpjekjet e tyre akademike. Kapitulli 13, i Rregullores akkademike përcakton qartësisht procesin e vlerësimit.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Pasi procesi i vlerësimit nga lektori përfundon dhe nota është llogaritur, studentët njoftohen përmes sistemit Populi dhe me email që notat janë regjistruar në sistem. Studentët kanë një periudhë prej 5 ditësh për të paraqitur ankimimin e mundshëm. Çdo ndryshim i mundshëm në notë duhet të aprovohet nga Dekani për t'u marrë parasysh si i vlefshëm. Ky proces siguron transparencë dhe drejtësi në vlerësimin e studentëve, duke ofruar mundësi për shqyrtim të mundshëm të çdo mosmarrëveshjeje. |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes<br>Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike<br>Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG<br>Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</td><td colspan="4">Rregullorja për ankesat e studentëve dhe procedurat e apelimit akademik përcakton qartësisht të gjitha hapat dhe procedurat që duhet ndjekur për shqyrtimin e ankesave. Studenti ka të drejtën të bëjë apel akademik në rast se konsideron se ka pasur një gabim në vlerësimin e provimit. Ky apel është një kërkesë për rishikim të një vendimi të marrë nga një vlerësues ose bordi i provimeve. Nëse ankesa merret parasysh, studentit i ofrohet mundësia për të ribërë provimin. Në rastin se një provim do të ribëhet, përgjegjësi i departamentit, pas konsultimit me vlerësuesin ose bordin e provimeve, cakton një datë të re për zhvillimin e provimit.<br><br>Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike<br>Evidenca Nr. 21: Rregullorja për ankesat e studentëve dhe procedurat e apelimit akademik</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ gjykon se Akademia NG siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Ky proces është i strukturuar dhe i dokumentuar në mënyrë të qartë, për të garantuar integritetin dhe besueshmërinë e tij. Akademia ka implementuar procedura të qarta për vlerësimin e studentëve, të cilat janë të aksesueshme dhe të kuptueshme për të gjithë palët e interesuara. Për më tepër, procesi i ankimimit është i përcaktuar në mënyrë të detajuar, duke ofruar mundësi të barabarta për studentët që ndjejnë se vlerësimi i tyre nuk ka qenë i drejtë. Këto masa sigurojnë që çdo student të trajtohet me drejtësi dhe transparencë, duke kontribuar në një mjedis akademik të besueshëm dhe të respektuar.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi III.4<br>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë</td><td>Ky program studimi synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive shkencore dhe profesionale të studentëve. Në përfundim të programit, studentët kryejnë praktikën profesionale dhe mbrojnë</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | temën e Masterit. Ky program i ofron studentëve mundësinë për të thelluar njohuritë në fushën e biznesit dhe menaxhimit. Struktura e programit është zhvilluar në përputhje me kërkesat e tregut për profesionistë me ekspertizë të lartë, e cila arrihet përmes moduleve që fokusohen në avancimin e njohurive dhe aftësive në fushën e menaxhimit dhe biznesit.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i përshkrimit të moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes*<br>*.Evidenca Nr. 18: Student Handbook* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" ofrohet në gjuhë angleze. Bazuar kurrikulës së tij, përshkrimit të lëndëve, literaturës së përdorur gjykojmë se ky program synon zhvillimin e aftësive dhe njohurive të avancuara në fushën e biznesit dhe menaxhimit. Modulet që përfshihen në këtë program janë të strukturuara për të përmbushur kërkesat e tregut të punës, duke u përshtatur me nevojat e sektorit privat dhe publik në kontekstin shqiptar.<br><br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 11: Katalogu i përshkrimit të moduleve -Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil në Biznes.*<br>*Evidenca Nr. 18: Student Handbook* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Bazuar në vizitën në institucion GVJ konstatoi se në përfundim të modulit personeli akademik bën një vlerësimin të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në programin e modulit. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Personeli akademik i angazhuar në këtë program stimulon pjesëmarrjen aktive të studentëve në auditor, duke realizuar me sukses objektivat e lëndëve përkatëse. Ky personel ka kualifikimin e duhur për të realizuar mësimdhënien, duke siguruar një përvojë të pasur mësimore. Mësimdhënia ka për qëllim të integrojë njohuritë teorike me aftësitë praktike, duke krijuar mundësi për zhvillimin e aftësive të studentëve në mënyrë të balancuar dhe efektive. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Orët e hapura janë organizuar me profesorë të ftuar si rezultat i bashkëpunimeve. Kjo ka sjellë një diversitet të pasur në mësimdhënie dhe ka mundësuar një shkëmbim të vlefshëm përvojash dhe njohurish mes stafit akademik dhe kolegëve të tyre në universitetet ndërkombëtare. Ky bashkëpunim ka pasuruar programin e studimit.<br><br>*Shtojca Nr. 12: Raporti vjetor i Akademisë "Nehemiah Gateway" viti akademik 2022 – 2023*<br>*https://www.ng-university.org/al/trajnime-biznesi* |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway" angazhohet në nxitjen dhe mbështetje të zhvillimit të ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore nga studentët. Kjo bëhet përmes krijimit të mundësive për realizimin e projekteve kërkimore. Studentët inkurajohen të angazhohen në aktivitete kërkimore duke i mundësuar që të zhvillojnë aftësitë e tyre akademike.<br><br>Bazuar në rregulloren e brendshme për funksionimin e njësisë bazë të Qendrës Kërkimore Shkencore dhe publikimeve akademike të |

| | |
|---|---|
| | Akademisë Nehemiah Gateway, neni 10 mbi financimin e kërkimit shkencor dhe bazuar referencës në këtë dokument lidhur me kërkimin shkencor, për të zhvilluar punën kërkimore dhe aktivitetet e veta për vitin 2022, në buxhetin e saj, Akademia Nehemiah Gateway ka parashikuar 5% të buxhetit total të Akademisë; ndërsa buxheti për kërkimin shkencor përbën 2.6% të buxhetit total të Akademisë. Buxheti i Qendrës së Kërkimit Shkencor hartohet nga Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore, propozohet në Senatin Akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit. Në buxhetin e kërkimit shkencor për 2022 janë llogaritur: kërkime shkencore dhe publikime 335,500 lekë; seminare dhe trajnime 146,400 lekë; kualifikime dhe konferenca 427,000 lekë dhe udhëtimi studimor 890,600 lekë.<br><br>*Shtojca Nr. 15_EO_Rregullore per funksionimin e Qendres Kerkimore-Shkencore_al*<br>https://www.ng-university.org/al/kerkimi/fondi-i-kerkimit-shkencor |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon se Programi i studimit"Master i Shkencave" në "Menaxhim" me profil në "Biznes" garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Ky program kontribuon në përgatitjen e studentëve për pozita udhëheqëse dhe menaxheriale në sektorin e biznesit përmes një kurrikulë të strukturuar dhe të përshtatshme, e cila integron njohuri teorike dhe praktike, duke u fokusuar në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe shkencore të studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Institucioni, përmes akteve të brendshme të miratuara, ka të përcaktuara procedurat në lidhje me detyrimet përmbyllëse të studentëve, si Rregullore e Programit të Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes; Rregullore Akademike, |

| | |
|---|---|
| | Rregullore për Procedurat për Ankesat dhe Apelimet Akademike të Studentëve, etj.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve*<br>*Evidenca Nr. 21: Regulation on Student Complaints and Academic Appeals Procedures* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Personeli akademik, së bashku me stafin ndihmës akademik, ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke siguruar informacionet, udhëzimet dhe materialet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse. Rregulloret që lidhen me këtë proces janë të disponueshme për studentët në faqen zyrtare të institucionit, si dhe në sistemin Populi, për t'u siguruar që çdo informacion është i qartë dhe i aksesueshëm.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu Akademisë NG*<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Në kuadër të këtij programi studimi, detyrimi përmbyllës realizohet përmes hartimit të temës së masterit, e cila është në përputhje me rregulloren e institucionit. Tema e masterit ka vlerën e 20 krediteve.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes*<br>*Shtojca Nr. 10: Kurrikula Menaxhim me Profil në Biznes* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës | Studenti ka një këshillues akademik, i cili e udhëheq dhe orienton atë gjatë gjithë procesit të përgatitjes së tezës. Ky këshillues asiston studentin duke siguruar përputhjen me udhëzuesit dhe standardet akademike të miratuara.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |

| | |
|---|---|
| sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Institucioni ofron mbështetje akademike, infrastrukturore dhe teknologjike për studentët në realizimin e kërkimeve shkencore. Mbledhja e të dhënave realizohet përmes pyetësorëve që shpërndahen nëpërmjet kanaleve digjitale. Analiza e të dhënave bëhet përmes sistemit Populi, duke siguruar një proces të thjeshtuar dhe efikas në vlerësimin e informacionit të mbledhur.<br><br>*Evidenca Nr. 22: Guide for writing a Bachelor or Master Thesis* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me një notë që reflekton nivelin e tij të njohurive dhe aftësive të treguara.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të procesit të diplomimit, institucioni pajis studentin me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës, të cilat janë të miratuara dhe në përputhje me standardet përkatëse të programit të studimit.<br><br>*Shtojca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Institucioni arkivon dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe të gjitha fazat e tij deri në diplomimin e studentit, në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe akte të brendshme në fuqi. |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se Akademia NG ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Këto procedura janë të dokumentuara dhe të miratuara për të siguruar një proces* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *të drejtë dhe transparent për studentët. Për më tepër, akademia ofron mbështetje të plotë për studentët gjatë gjithë procesit përmbyllës, duke siguruar që ata të kenë akses në informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të përfunduar me sukses programin e studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | NA |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | NA |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | NA |





| Konkluzione | *Programi është Master Shkencor dhe jo Master Profesional.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | GVJ bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi se Akademia NG ka nënshkruar një marrëveshje me MAS, nr prot 4806/1, datë 26.07.2023, "Mbi përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë në njësinë bazë, në Akademinë NG", në të cilën përcaktohet numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë që do të kenë në përbërje njësitë bazë të akademisë, si edhe numri minimal i personelit akademik që duhet të ketë gradë shkencore ose tituj akademik. Sipas nenit 3, pika 1, përcaktohet se nëse Akademia NG për të paktën 3 vite akademike nuk ka më shumë se treqind studentë dhe përmbush kushtet e kodit të cilësisë të procesit mësimor, mund të mos plotësojë kushtin e përcaktuar në pikën 4, të nenit 25, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Sipas nenit 3, pika 2,të marrëveshjes, me nr prot 4806/1, datë 26.07.2023, ''Mbi përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë në njësinë bazë, në Akademinë NG'', midis MAS dhe Akademisë, përcaktohet se |

Departamenti i Menaxhimit, Departamenti i Biznesit dhe Qendra Kërkimore Shkencore, që janë njësi bazë të Fakultetit të Biznesit dhe Menaxhimit, do të kenë të paktën 4 anëtarë të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën dy të kenë grade shkencore ose tituj akademik.

Departamenti i Menaxhimit përgjegjës për programin "Menaxhim" me profil në "Biznes" në Fakultetin e Biznesit dhe Menaxhimit përbëhet nga:

(Viti akademik 2023 - 2024)

| Tituj/grada | **2023 – 2024** | |
|---|---|---|
| | PAE | PAK |
| Prof. Dr | 1 | 1 |
| Prof. As. Dr | - | - |
| Dr/PhD | 2 | - |
| Msc | 2 | - |
| Në total | **5** | **1** |

Gjithashtu, te dhenat e Personelit akademik te angazhuar per programin e studimit, per V.A 2022-2023, 2023-2024, jane si me poshte:

| Tituj/grada | **2022 – 2023** | |
|---|---|---|
| | PAE | PAK |
| Prof. Dr | 2 | 1 |
| Prof. As. Dr | - | - |
| Dr/PhD | 1 | - |
| Msc | 2 | - |
| Në total | **5** | **1** |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td rowspan="2">Tituj/grada</td><td colspan="2">2023 – 2024</td></tr>
<tr><td>PAE</td><td>PAK</td></tr>
<tr><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof. As. Dr</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>4</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>1</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Në total</td><td>5</td><td>1</td></tr>
</table>
<br>
Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway ", seksioni 22<br>
Tab. Nr. 2 – Tabelat përmbledhëse
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</td>
<td>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë në programin e studimit Master i Shkencave "Menaxhim" me profil në Biznes mbulon së paku 70% të lëndëve të programit.<br><br>
Per vitin 2022-2023, PAE ka realizuar 75% te programit ne perputhje me normativen ne fuqi: PAE 540 (75 %) + PAK 180 (25 %) = 720 (100 %).<br>
Per vitin 2023-2024, PAE ka realizuar 87,5% te programit ne perputhje me normativen ne fuqi: PAE 420 (87.5 %) + PAK 60 (12.5 %) = 480 (100 %)<br><br>
Për V.A 2022-2023 dhe 2023-2024, Persoenli akademik efektiv (PAE) i angazhuar plotëson më ngarkesë më shumë se 70 % të programit të studimit.<br><br>
Evidenca: Tabelat përmbledhëse (Tab. 6.2/ Tab. 4)<br>
Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway ", seksioni 22<br>
Evidenca Nr. 20: Faculty Hnadbook<br>
Evidenca Nr. 42: Msc program
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se personeli akademik për programin e studimit MSc. Menaxhim Profil Biznes, i angazhuar me kohë të plotë dhe në kohë të pjesshme disponojnë kontrata pune në përputhje me Kodin i Punës, duke përfshirë të gjitha kërkesat kontraktuale si aspektet financiare, sigurimet shoqërore dhe të gjitha komponentët e tjera të kontratës.<br><br>*Evidenca Nr. 27: Model Kontrate Pune* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se procedurat e punësimit të Akademisë "Nehemiah Gateway" janë në përputhje me kuadrin ligjor si dhe IAL ka akte rregullative të brendshme lidhur me punësimin (Manualin e Politikave, në intranetin e NG Team).<br>IAL, gjiathshtu ka një listë kriteresh të miratuara për përzgjedhjen e Lektoreve të ftuar të cilët janë akademikë nga universitete ndërkombëtare.<br><br>*Evidenca Nr. 27: Model Kontrate Pune*<br>*Evidenca Nr.28: Kriteret për rekrutimin e lektorëve të ftuar në Akademinë "Nehemiah Gateway"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | **N/A** |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të | Institucioni administron të dhënat që i referohen burimeve njerëzore të angazhuar në programin e studimit. Në të dhënat e administruara specifikohet mënyra e angazhimit të personave përgjegjës për çdo vit akademik apo semestër. Personeli raporton për arritjet profesionale në bazë vjetore. Zyra e Burimeve Njerëzore si njësia përgjegjëse administrative, ruan dhe përditëson si të dhënat e stafit akademik, ashtu edhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Administrimi i të dhënave të |

| | |
|---|---|
| personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | personelit realizohet si në formatin fizik, nëpërmjet dosjeve të përsonelit, ashtu edhe në formatin elektronik.<br><br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway ", seksioni 22*<br>*Evidenca: Tabelat përmbledhëse (Tab. 2; 4; 6.2)*<br>*Evidenca Nr. 19: Academic Regulation_HEI Nehemiah Gateway* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon një sistem efikas orientimin e studentëve, që nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të ciklit që përmbyllet me diplomën. Informacioni ofrohet si gjatë mësimit, trajnimit orientues në një proces periodik deri në fund të studimeve. IAL ka të miartuar një person si këshillues akademik për udhëzimin dhe mentorimin e studentëve, i cili duhet të konsultohet të paktën një herë në tremujor nga ana e studentit.<br><br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve, seksioni 12, fq. 18*<br>*https://www.ng-university.org/en/ba*<br>*https://www.ng-university.org/en/admissions*<br>*Evidenca Nr. 9: Guide on Intership MSc Program*<br>*Evidenca Nr. 8: Cooperation Agreements* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon një sistem efikas informacioni për orientimin e studentëve gjatë gjithë ciklit të jetës së studentit, përmes trajnimit orientues në një proces periodik deri në fund të studimeve. IAL ka të miratuar një person si këshillues akademik për udhëzimin dhe mentorimin e studentëve, i cili duhet të konsultohet të paktën një herë në tremujor nga ana e studentit.<br><br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway ", pjesa D, seksioni 15*<br>*Evidenca Nr. 9: Guide on Intership MSc Program*<br>*Evidenca Nr. 8: Cooperation Agreements* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisisht pasi Akademia "NG" ka të angazhuar Personel akademik që përmbush standardet sasiore dhe cilësore në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit MSc. Menaxhim Profil Biznes.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.2<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor por dhe jetës së studentit me kushtet e një kampusi. Hapësira sipërfaqësore e disponueshme është në përputhje me normën sipas kuadrit ligjor në fuqi (7 m2 për student).<br>*Evidenca Nr. 29: General Facilities*<br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway (kapitulli 15)* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon brenda kampusit mjedise mësimore me një infrastrukturë të përshtatshme teknologjike/dixhitale për zhvillimin e procesit mësimor teorik dhe praktik për mësimdhënie/mësimnxënie moderne sipas standardeve të përcaktuara.<br><br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway (kapitulli 15)* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon auditore/klasa me kushtet e nevojshme për zhvillimin teorik dhe praktik të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Me specifikisht, ky program studimi ne permbushje te profilit te tij biznes, ka ne dispozicion nje klase laborator kerkimor te pajisur me 10 PC per te zhvilluar kerkim apo ushtrime praktike ne fushen e IT. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| formues të programit të studimit në tërësi. | *Evidenca Nr. 7: Katalogu i Akademisë „Nehemiah Gateway (kapitulli 15)* | | | |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon salla me pajisje SMART, lidhje wi-fi, projektorë etj., si dhe një laborator kërkimor me 10 PC në funksion të studentëve dhe stafit akademik.<br><br>*Evidenca Nr. 29: General Facilities*<br>https://www.ng-university.org/al/regjistrimet/facilities | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Programi i studimit "Menaxhim" me profil në "Biznes" ka në kurikul "Praktikën Mësimore" ku studentët mund të zbatojnë në rrafshin praktik dijet teorike të përftuara. Praktika realizohet në bashkëpunim me biznese, kompani dhe organizata. Akademia "Nehemiah Gateëay" ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL partnere ndërkombëtare, dhe institucione të tjera për të zhvilluar më tej vizionin dhe misionin e saj.<br><br>*Evidenca Nr. 11: Katalogu i Përshkrimeve të Moduleve*<br>*Evidenca Nr. 9: Guide on Intership MSc Program* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht, pasi Akademia "NG" ka siguruar mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit MSc. Menaxhim (Profili: Biznes) të përputhshme si për formimin teorik apo atë praktik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se studentët e Programit të studimit "Menaxhim" me profil në "Biznes" përvec teksteve dhe literaturës në *hard copy,* kanë mundësi aksesi të barabartë dhe në burime online., të tilla si: JSTOR përmes platformës Populi. Literatura e nevojshme për modulet mund të aksesohen me Link edhe në hapësirën e platformës Populi dedikuar lëndës përkatëse.<br><br>https://www.ng-university.org/application/files/6416/8983/5274/Katalogu_i_pershkrimit_te_moduleve_M.Sc.pdf<br>*Evidenca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon një planifikim buxhetor për të siguruar suportin e nevojshmë financiar në funksion të fondit të bibliotekës, materialeve didaktike, burimeve njerëzore si dhe pajisjet teknologjike të nevojshme për mësimdhënien dhe mësimnxënien.<br>https://www.ng-university.org/application/files/6416/8983/5274/Katalogu_i_pershkrimit_te_moduleve_M.Sc.pdf<br>*https://www.ng-university.org/al/kerkimi/fondi-i-kerkimit-shkencor*<br>*Evidenca Nr. 11: Katalogu i pershkrimit te moduleve* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila përmban librat, periodikët dhe materialet sin ë aspektin fizik (hard copy) por dhe online. Biblioteka bën pjesë në rrjetin e bibliotekave COBISS, si dhe ka bashkëpunime me biblioteka si Biblioteka Shtetërore Bavareze në Mynih, Gjermani etj Studentët, mund të aksesojnë falas në JSTOR përmes platformës Populi, për të gjetur literaturën e moduleve por dhe atë në fushën e kërkimit. Të gjithë studentët kanë akses te plote që në momentin që rregjistrohen në këtë institucion. |

| | |
|---|---|
| programit të studimit. | |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon një bibliotekë me një fond prej 11000 librash. Sipas Planit të zhvillimit Strategjik synohet rritja e burimeve të bibliotekës me 1000 vëllime librash kurikulare në gjuhën shqipe dhe angleze. IAL ka bërë një planifikim të buxhetit vjetor prej 1000 Euro për çdo vit për rritjen e fondit të materialeve mësimore të Akademisë "Nehemiah Gateway".<br><br>*Shtojca Nr. 17: Plani Strategjik, fq. 36* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" disponon burime me libra fizikë por dhe library online "JSTOR" falas që mund të aksesohen nga stafi dhe studentët përmes platformës Populi. Literatura për modulet ngarkohet në portal ku mund të aksesohen nga studentët gjatë mësimdhënies dhe jo vetëm.<br>https://www.ng-university.org/en/ba/library |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" ka një infrasttukturë të përshtatshme me facilitate teknologjike si dhe një sallë laboratorike me 10 PC në përdorim të studentëve dhe stafit akademik.<br><br>**https://www.ng-university.org/al/kerkimi/fondi-i-kerkimit-shkencor**<br>https://www.ng-university.org/application/files/7115/8689/1515/0033_Library_Information_Regulation.pdf<br>https://www.ng-university.org/al/ba/biblioteka |

| | |
|---|---|
| kufizim për të gjithë studentët. | |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemiah Gateway" ka në dispozicion bibliotekën ku informohet oraret e përdorimit si dhe një person përgjegjës për funksionimin dhe adminsitrimin në sherbim të studentëve dhe stafit.<br><br>*Evidenca Nr. 20: Katalogu i Fakultetit*<br>*https://www.ng-university.org/en/ba/library*<br>https://www.ng-university.org/application/files/7115/8689/1515/0033_Library_Information_Regulation.pdf<br>**https://www.ng-university.org/al/kerkimi/fondi-i-kerkimit-shkencor** |
| **Kriteri 8.**Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë | GVJ bazuar në materialet mbështetëse por dhe gjatë vizitës në institucion, se biblioteka e Akademia "Nehemiah Gateway" është anëtare e sistemit të bibliotekave COBISS (Co-operative Online Bibliographic Systems and Services) një platformë për sistemet kombëtare të informacionit të bibliotekave në Slloveni, Serbi, Maqedoninë e Veriut, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Bullgari, Shqipëri dhe Kosovë, ku mund të aksesohen rreth 1.000.000 revista shkencore, si dhe bibliografitë e studiuesve.<br><br>https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/perdorimi-i-fondeve<br>*Evidenca Nr. 32: External Audit Reports 2022-2024* |

| | |
|---|---|
| qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht, pasi Akademia "NG" ka siguruar një bibliotekë dhe një sistem online literatutë që përmbush realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit MSc. Menaxhim (Profili: Biznes).* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | GVJ konstatoi se Akademia "Nehemia Gateway ", disponon një sistem informimi dhe këshillimi për studentët, që nis që me fillimin e procesit mësimor dhe vazhdon në mënyrë periodike gjatë gjithë ciklit të jetës së studentit. Studentët zotërojnë një adresë elektronike të personalizuar për të aksesuar në intranet ku ka të përfshirë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi modulet, metodat e mësimdhënies duke komunikuar në mënyrë interaktive me pedagogët. Shkembimi i informacionit bëhet përmes sistemeve si: Populi, Website dhe postera. Gjithashtu, sistmi Populi përdoret si sistem të menaxhimit kontentit dhe komunikimit në mësim.<br>Inastitucioni ka në përdorim platformën Populi si sistem të menaxhimit kontentit dhe komunikimit në mësim.<br><br>https://ng-university.populiweb.com/<br>*Shtojca Nr. 19: Rregullore Akademike, kapitulli 4*<br>**https://www.ng-university.org/al/ba/Procesi-i-aplikimit** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemia Gateway" përdor Populi si një sistem të brendshëm të menaxhimit i cili përmban facilitetet e nevojshme për të menaxhuar operacionet e |

| | |
|---|---|
| aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | komunikimit, publikimit, klasifikimit dhe administrative. Në këtë platformë studentët informohen për arritjet e tyre akademike si dhe të ndërveprojnë me lektorët në kuadër të mësimnxënies.<br><br>*Shtojca Nr. 19: Rregullore Akademike, kapitulli 4* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se sistemi i menaxhimit Populi që është në përdorim të Akademia "Nehemia Gateway", përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për të adresuar nevojat e personelit akademik si dhe të studentëve për programin e studimit Msc Menaxhim me profil në Biznes. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit në përdorim të Akademisë, ka platformën e komunikimit ndërveprues në lidhje me cdo element të mësimnxënies dhe vlerësimit kumulativ, sistem në përdorim për të gjithë studentët dhe stafin e angazhuar për secilin modul të programit të studmit. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se sistemi i menaxhimit Populi që është në përdorim të Akademia "Nehemia Gateway", përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për të monitoruar në kohë reale përmes Administratorit Akademik dhe Auditorit Akademik aktivitetin e stafit akademik dhe administrativ në plotësimin e detyrimeve sipas roleve. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, se Akademia "Nehemia Gateway" ka në dispozicion një zonë download ne faqen web ku studentët mund të aksesojnë informacion për programin e studimit, në gjuhën angleze dhe shqipe.<br><br>https://www.ng-university.org/al<br>https://www.ng-university.org/en<br>https://www.ng-university.org/al/staff-menu/download-center |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se Akademia "Nehemia Gateway" disponon një sistem të brendshëm efikas të menaxhimit institucional të* |

| | |
|---|---|
| | *informacionit për veprimtarinë akademike dhe admisnitrative në përmbushje të misionit të programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ konstatoi se Akademia "Nehemia Gateway ", ka në dispozicion një buxhet vjetor i cili hartohet nga Administratori i akademisë në bazë të propozimeve të njësive përbërëse të saj. Buxheti miratohet nga Bordi Administrimit dhe Senati Akademik. Gjithashtu, ka një procedurë të qartë lidhur me planifikimin dhe realizimin e buxhetit.<br><br>*Evidenca Nr. 30: Udhëzimet për Buxhetin*<br>*Evidenca Nr. 31: Buxheti i M.Sc. "Menaxhim" me profil në „Biznes "2022-2024* |





| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.**Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës, se Akademia "Nehemia Gateway dipsonon palanifikimin e nevojshëm financiar, sa i takon shpenzimeve lidhur me personelin, objektet, teknologjinë dhe fondin e bilbliotekës për programin e studimit Msc. Menaxhim me profil "Biznes". Akademia "Nehemiah Gateëay" e cila është nën Fondacionin NG Albania mbështetet kryesisht nga donacione dhe bursa. NG Services gGmbH, me seli në Nuremberg, mbështet organizatat brenda NG Team me detyra administrative në fushat e marketingut, burimeve njerëzore, çështjeve ligjore dhe një sërë detyrash koordinuese. Planifikimi i buxhetit kryhen në bashkëpunim të ngushtë me fondacionin mëmë, NG Services gGmbH, i cili ushtron funksion mbikqyrës dhe kontribuon me financat, të krijuara nga administrimi i aseteve të veta dhe veprimtarisë së biznesit, si dhe mbulon plotësisht të gjitha shpenzimet e përgjithshme dhe administrative.<br><br>*Evidenca Nr. 30: Udhëzimet për Buxhetin*<br>*Evidenca Nr. 31: Buxheti i M.Sc. "Menaxhim" me profil në „Biznes "2022-2024*<br>*Evidenca Nr. 32; 33; 34.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës, se Akademia "Nehemia Gateway" si institucion arsimor e NG Albania, realizon çdo vit audimitimin e jashtëm me kërkesë të Bordit Mbikëqyrës. Raporti i kontrollit nga auditimi i jashtëm i dorëzohet Zyrës së Tatimeve dhe një kopje i jepet Bordit Mbikëqyrës të NG Albania. Gjithashtu, Akademia "Nehemiah Gateway" ka në shërbim dhe konsulntë të jashtëm Kontabilist të Certifikuar (CPA) nga SHBA, i cili përfshihet në procesin vjetor të rishikimit të aktiviteteve financiare. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditit janë transparente dhe të publikuara në faqen web. Akademia si pjesë përbërëse e NG Albania, ndjek dhe zbaton politikat financiare sipas Manualit të NG Team.<br><br>*Evidenca Nr. 34: Protokollet e Takimeve Financiare* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi | GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateëay" ka një sistem raportimi transparent të buxhetit me njësitë përbërëse që nga planifikimi sipas nevoja të njësive e deri te diskutimi i buxhetit me të gjitha njësitë sipas nevojave. |

| | |
|---|---|
| realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | *Evidenca Nr. 34: Protokollet e Takimeve Financiare* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway" financohet përmes të ardhurave të gjeneruara nga tarifat, granteve, dhurimeve dhe kontributeve nga personat fizikë dhe juridikë private ose publike në Shqipëri dhe jashtë saj në përputhje me Stautin e saj dhe ligjislacionin financiar në fuqi.<br><br>https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/perdorimi-i-fondeve |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway" garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programit të studimit MSc Menaxhim në Biznes.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e | GVJ konstaton se Akademia Nehemiah Gateway ka një procedure të miratuar për pranimin e studentëve e cila është e aksesueshme dhe në faqen web. Procedura e pranimit është në përputhshmëri me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e MAS. |

| | |
|---|---|
| plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Kriteret dhe porcedurat e diplomimit parashikohen në Rregulloren Akademike të Akademisë.<br><br>*Evidenca Nr. 35: Procedurat për Pranimin dhe Regjistrimin e Studentëve*<br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike (neni 7, 16, 17, 18, 22.1, 22.2, 22.3, 22.4, 23 & 24)* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe gjatë vizitës dhe takimit me studentët, se Akademia "Nehemia Gateway "garanton barazinë dhe të drejtat e studentëve që nga momenti i regjistrimit e deri në përfundimin e cikli të të studimit që përmmbyllet me displomimin.<br>https://www.ng-university.org/application/files/8416/8966/3125/Admission_and_Enrolment_Procedure.pdf<br>https://www.ng-university.org/application/files/9515/8689/1515/2012-160_en_FO_Application_Form_N.G._University.pdf<br>https://www.ng-university.org/application/files/4517/0653/7156/Catalog_of_HEI_Nehemiah_Gateway.pdf<br>*Evidenca Nr. 18: Katalogu i Studentëve, fq. 9*<br>*Evidenca Nr. 36: Rregullore e programnit te studimit (Pika 8 – deklarata e mosdikstiminimit.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe gjatë vizitës dhe takimit me studentët, se Akademia "Nehemia Gateway, ka të publikuar procedurat për pranimin e studentëve në programin master shkencor në "Menaxhim "me profil në „Biznes".<br><br>*Evidenca Nr. 35: Procedurat për Pranimin dhe Regjistrimin e Studentëve, neni 5*<br>*Evidenca Nr. 36: Rregullore e programnit te studimit (Pjesa B – Pranimet)*<br>*https://www.ng-university.org/al/ba/Procesi-i-aplikimit*<br>https://www.ng-university.org/application/files/8416/8966/3125/Admission_and_Enrolment_Procedure.pdf<br>https://www.ng-university.org/application/files/9515/8689/1515/2012-160_en_FO_Application_Form_N.G._University.pdf |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe | GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway, zbaton një procedure pranimi për të gjithë studentët e rinj dhe është e publikuar në faqen e internetit të tij. Procedura e pranimit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit në |

| | |
|---|---|
| përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | fuqi dhe udhëzimet e MAS. Institucioni disponon një dokument të qartë "Procedurat për Pranimin dhe Regjistrimin e Studentëve" ku përfshihen të gjithë elementët si regjistrimi, matrikulimi dhe transferimi i studimeve. Të dhënat janë gjithashtu të pasqyruar në faqen web. https://www.ng-university.org/en/ba/application-process<br>*Evidenca Nr. 35: Procedurat për Pranimin dhe Regjistrimin e Studentëve* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ konstaton Akademia "Nehemiah Gateway" publikon në faqen zyrtare, kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për pranimin e kandidatëve në çdo program. IAL informon cdo vit MAS sipas udhënzimeve të përcaktuara.<br>https://www.ng-university.org/en/about-us<br>**https://www.ng-university.org/en/ba/application-process** |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe nga vizita në institucion, Akademia "Nehemiah Gateway" parashikon ne Rreguloren e saj (kreu IX) kriteret e vecanta për përzgjedhjen e kandidatëvë me aftësi të vecanta.<br><br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike, kapitulli 9* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe nga vizita në institucion, Akademia "Nehemiah Gateway" parashikon ne Procedurat e Pranimit dhe Regjsitrimit (Neni 5) kriteret e Pranimit dhe Regjistrimit në programin Master Shkencor për Kandidatët internacionalë. |

| | |
|---|---|
| akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | https://www.nguniversity.org/en/ba/application-process/international-ba |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | GVJ konstaton se Akademia "Nehemiah Gateway" ka një kontribut me impact social prej mbi 30 vitesh: ofrim bursash për fëmijët/të rinjtë nga kategoritë shoqërore në nevojë dhe komunitetin Rom duke filluar nga kopshti dhe deri në Arsimin e Lartë. Bursa ofrohet edhe për studentë nga vendet e treta si Afrika dhe Amerika qendrore.<br><br>https://www.nehemiah-gateway.org/en/projects/scholarships-international-talents/amaro-tan-scholarship |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway" harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të barabarta dhe transparente për pranimin, përzgjedhjen, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit MSc Menaxhim profili: Biznes.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe gjatë vizitës dhe takimit me studentët, se Akademia "Nehemia Gateway" ofron informacion të detajuar mbi kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin (pika 12.4 të Katalogut të institucionit). Numri i krediteve të domosdoshme për kalimin nga një vit te tjetri si dhe humbja dhe përsëritja e vitit për shkak të mos plotësimit të saj, prashikohet ne Rregulloren Akademike.<br><br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i institucionit, pika 12.4* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike, pika 14.6* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway" ka të parashikuar në Rregulloren e Programit Master në mënyrë të detajuar procesin e njohjes/transferimit të krediteve.<br><br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i institucionit*<br>*Evidenca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe gjatë vizitës dhe takimit me studentët, se Akademia "Nehemia Gateway" informon studentët në lidhje me kriteret e vlerësimit të cilat janë të përcaktuara qartë në Katalogun e Përshkrimit të secilit Modul ku jepen të specifikuara me përqindje të gjitha elementët e vlerësimit kumulativ që duhet të fitohen për secilin modul të Programit të Studimit.<br><br>*Evidenca Nr. 7: Katalogu i institucionit*<br>*Evidenca Nr. 36: Rregullore e Programit te Studimit Master Menaxhim me profil ne Biznes* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway" informon përmes një udhëzuesi të posacëm kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës si dhe diplomimit për studentët e MSc Menaxhim me profil në Biznes.<br><br>*Evidenca Nr.22: Guide for writing BA and Master Thesis.*<br>*Evidenca Nr. 36: Rregullorja për Programin Master, pika 27, fq. 29* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe gjatë vizitës, se Akademia "Nehemia Gateway" informon studentët potencialë përmes Qendrës së Shërbimeve Studentore duke realizuar veprimtari promovuese lidhur me kriteret e studimit në Akademinë "Nehemiah Gateway", Sistemin e Bursave, materialet e aplikimit dhe ndihmën në plotësimin e portalit të studentit në internet etj.<br><br>*Evidenca Nr. 39: Rregullorja për Qendrën e Shërbimeve Studentore* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia "Nehemia Gateway" ka vëne në dispozicion të studentëve të programit të studimit MSc Master me profil Biznes, informacionin e nevojshëm mbi vlerësimin e dijeve,* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *njohjen dhe transferimin e krediteve deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe diplomimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Gjatë takimeve në institucion, rezultoi se informimi i studetëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet Qendrës së Shërbimeve Studentore, komunikimit me zyrën e pranimit kur ata aplikojnë. Gjithashtu një informacion i përgjithshëm shfaqet në webfaqen e Akademisë "NG". Akademia është angazhuar në informimin dhe orientimin e studentëve në procesin e zbatimit të programit përmes paketave informuese por dhe përmes këshilltarit akademik gjatë gjithë ciklit të studimeve.<br><br>*Evidenca Nr. 36: Rregullorja për Programin Master* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | GVJ konstaton nga dokumentacioni por dhe gjatë vizitës, rezultoi se informimi i studetëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet Qendrës së Shërbimeve Studentore, komunikimit me zyrën e pranimit kur ata aplikojnë. Gjithashtu një informacion i përgjithshëm shfaqet në webfaqen e Akademisë "NG". Informacioni i detajuar për kurrikulat, planin mësimor, kreditet, objektivat mësimore dhe rezultatet e të nxënit të programit të studimit jepet në Përshkrimin e Modulit.<br><br>*Evidenca Nr. 11: Katalogu i Përshkrimeve të Moduleve* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për | GVJ konstaton se NG Team me rrjetin ndërkombëtar të kompanive dhe sipërmarrjeve partnere ofron mundësi punësimi për studentët. Gjithashtu, njësia përgjegjëse për programin në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njësisë së Cilësisë, zhvillojnë në mënyrë periodike studime për tu përditësuar me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.<br>*Evidenca Nr.8: Cooperation agreements*<br>*Tabela 5, Aneks tabelat permbledhese* |





| | |
|---|---|
| orientimin drejt dhe në tregun e punës. | *https://www.ng-university.org/application/files/1616/8966/2773/Framework_Agreement_Firms.pdf*<br>**https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/ng-team**<br>**https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/partner%C3%ABt**<br>**https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/karriera**<br>**https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/alumni** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e njësisë kryesore, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e institucionit lidhur me mjediset qe do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, bibloteka, laboratorët etj. I gjithë informacioni është i aksesueshëm dhe në platformën Populi. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Akademia "Nehemia Gateway" përdor një sistem të dedikuar për menaxhimin e informacionit, Populi ku mëndësohet dhe regjsitrimi dhe ruajtja e të gjithë të dhënave për studentët. Sistemi ofron të gjithë informacionin mbi modulet, kreditet dhe ku kryhet dhe komunikimi interaktiv me pedagogët e secilit modul përmes postes elektronike.<br><br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike, pjesa A, seksioni 4* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se informacioni i vënë në dispozicion për studentët është i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm lidhur me objektivat, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit MSc Menaxhim me profil Biznesi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të Akademia NG.<br>Te dhenat mbi numrin e studenteve, kalueshmerine dhe normat e punesimit jane te publikuara ne faqen web<br><br>**https://www.ng-university.org/en/about-us/student-achievement-data**<br>• Facts and Figures (Download PDF) |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Sipas Rregullores institucioni mban të dhëna vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit. Një gjë e tillë u evidentua nga takimi me zyrën e sekretarisë mësimore dhe shqyrtimit të regjistrave të studentëve.<br><br>*Evidenca Nr. 37: Regjistri Bazë Digjital - M.Sc. 2022* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve ruheshin ne regjistra fizike te arkivuara si dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Gjithashtu, Akademia NG përdor sistemin Populi.<br><br>*Evidenca Nr. 37: Regjistri Bazë Digjital - M.Sc. 2022*<br>Të dhëna gjenden në faqen zyrtare të IAL-së nën Student Achievement Data (https://www.ng-university.org/en/about-us/student-achievement-data). |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin | Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se zotërohen dhe ruhen në mënyrë rigoroze të dhënat. Ato u shqyrtuan gjatë këtij |

| | |
|---|---|
| periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | procesi vlerësimi. Sekretaria mësimore dhe institucioni raporton këto të dhënë edhe në raportin vjetor, që Akademia "Nehemiah Gateway" i dërgon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku përfshihet numri i përditësuar i studentëve të diplomuar. Regjistrat plotësohen në formë të shkruar dhe format elektronik duke ruajtur të dhënat në zbatim të udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi.<br><br>*Evidenca Nr. 37: Regjistri Bazë Digjital - M.Sc. 2022* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | GVJ konstaton se Akademia "Nehemiah Gateway" përditëson në mënyrë periodike informacionin për arritjet e studentit, si dhe statistikat mbi shkallën e të diplomuarve/punësimit. Kjo realizohet përmes sondazheve me studentët e rinj, anketim me alumni dhe plotësimit të Anketës së Shërbimit Studentor lidhur me procesin e mentorimit të ofruar. Rezultatet e këtij sondazhi i shpërndahen nga Drejtuesi i QM-së tek Dekani i Fakultetit (HoF) për veprime të mëtejshme, sipas nevojës.<br>Të dhëna gjenden në faqen zyrtare të IAL-së nën Student Achievement Data (https://www.ng-university.org/en/about-us/student-achievement-data).<br>*Evidenca Nr. 40 – Alumni Survey Master* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia NG, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhënat në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit MSc Menaxhim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre | GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit se studentët janë të përfshirë dhe angazhuar në organizmat vendimmarrëse të Akademia NG: Senati Akademik (neni 18, Statuti), Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Komisioni i Disiplinës së Studentëve dhe |

<table>
<tr><td>në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</td><td colspan="4">Komisioni i Kurrikulës ku përfshihet përfaqësuesi i studentëve në takimet e tyre.<br><br>Evidenca 5 – Statuti (Neni 18, 30, 31)</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</td><td colspan="4">GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por dhe vizitës në institucion, se studentët janë të përfshirë dhe angazhuar në organizmat vendimmarrëse të Akademia NG: Komisioni i Disiplinës së Studentëve dhe Komisioni i Kurrikulës ku përfshihet përfaqësuesi i studentëve në takimet e tyre.<br><br>Evidenca Nr. 38: Protokollet e Takimeve të Komitetit të Kurrikulës</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</td><td colspan="4">GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por dhe vizitës në institucion, se studentët janë të përfshirë në procesin e marrjes së vendimeve, këshillimin ose vlerësimin e procesit akademik në Takimet e Komisionit të Kurikulës ku diskutohet në mënyrë periodike lidhur me ndryshimet e Kurrikulës për Programin MSc Menaxhim me profil Biznes.<br><br>Evidenca Nr. 38: Protokollet e Takimeve të Komitetit të Kurrikulës</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</td><td colspan="4">GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit se studentët këshillohen dhe nga zyra të tjera të Akademia NG duke përfshirë informimin për bursa, orientimin e tyre përmes këshillimit akademik si dhe këshillave dhe adresimit në rast ankesash të studentëve.<br><br>Evidenca Nr. 21: Rregullorja për Ankesat e Studentit dhe Procedurat e Apelimit Akademik</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ konstaton se Akademia NG përfshin studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të përmirësimit të kurikulës dhe sigurimit të cilësisë për programin e studimit.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
</table>





| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.6<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por dhe vizitës në institucion, se Akademia NG ka një strukturë të posacme Qendra e Shërbimeve Studentore e cila ofron një guidë të qartë mbështetëse për informimin dhe orientimin e studentëve vendas dhe të huaj. Ajo organizon takime informuese mbi statusin e studentit, katalogun e shërbimeve, procedurat që lidhen me mësimidhënien dhe metodologjinë e testimeve dhe trajnimin për aksesimin e cdo student në sistemin Populi përmes adresave të personalizuara.<br><br>*Evidenca Nr. 39: Rregullorja për Qendrën e Shërbimeve Studentore*<br>*https://www.ng-university.org/al/regjistrimet* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Akademia "Nehemia Gateway" përdor një sistem të dedikuar për menaxhimin e informacionit, Populi ku mëndësohet dhe regjsitrimi dhe ruajtja e të gjithë të dhënave për studentët. Sistemi ofron të gjithë informacionin mbi modulet, kreditet dhe ku kryhet dhe komunikimi interaktiv me pedagogët e secilit modul përmes postes elektronike.<br><br>*Evidenca Nr. 19: Rregullore Akademike, pjesa A, seksioni 4*<br>*Evidenca Nr. 39: Rregullorja për Qendrën e Shërbimeve Studentore*<br>*https://ng-university.populiweb.com/* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me | GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por dhe vizitës në institucion, se Akademia NG ka një strukturë të posacme Qendra e Shërbimeve Studentore e cila ofron një guidë lidhur me zhvillimin e karrierës dhe Edukimit të Vazhduar me qëllim aftësimin e tyre profesional për të qenë proaktiv me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit. Qendra e realizon këtë përmes takimeve për këshillimin e karrierës duke përfshirë: evente, takime, intervista me punëdhënës potencialë në nivel lokal dhe qendror. |

| | |
|---|---|
| kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | *Evidenca Nr. 39: Rregullorja për Qendrën e Shërbimeve Studentore*<br>*Evidenca Nr. 40: Template i pyetësorëve të Alumni*<br>*https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/partner%C3%ABt*<br>*https://www.ng-university.org/al/trajnime-biznesi*<br>*https://www.ng-university.org/al/regjistrimet*<br>*https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/alumni* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstaton se Akademia NG ka vënë në dispozicion dhe Anketën Alumni për gjenerimin e të dhënave të të cilës ka përgjgjësi Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-Shkencore. Të dhënat e analizuara përcillen te drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore.<br><br>*Evidenca Nr. 39: Rregullorja për Qendrën e Shërbimeve Studentore*<br>*Evidenca Nr. 40: Template i pyetësorëve të Alumni*<br>*https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/alumni* |
| **Konkluzione** | *GVJ kosntaton se Akademia: Nehemiah Gateway ka krijuar procedura dhe Qendrën e Shërbimeve Studentore me qëllim pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, dhe qe janë lehtësisht të menaxhueshme dhe të prekshme nga studentët e programit të studimit MSc Menaxhim me profil "Biznes".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |





| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Akademia NG ka zhvilluar seminare dhe trajnime për njohjen, zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mesimdhenies. Trajnimet e personelit akademik janë të orientuara në aspektet didaktike të mësimedhënies, duke nxitur përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Metodat e mësimdhënies janë të paraqitura dhe në kurrikulën e programit të studimit. Lëndët e përfshira në kurrikulën e programit u mundësojnë studentëve të zbatojnë metoda moderne të mësimdhënies, të nxënit si dhe të zgjerojnë bagazhin e dijes në lidhje me procesin e të mësuarit dhe hulumtimit.<br>*https://www.ng-university.org/al/trajnime-biznesi* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | GVJ konstaton se Akademia NG, disponon struktura përgjegjëse për garantimin e cilësisë duke ju referuar Katalogut të Njësisë Kryesore por edhe Rregulloren e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të garantuar procesin e mësimdhënies dhe më gjerë. Procesi i vlerësimit përfshin monitorimin e strukturave përbërëse dhe zbatimin e standardeve të cilësisë. Komisioni i cilësisë organizon në mënyrë periodike pyetësorë vlerësues për stafin me indikatorë matës si: cilësia e mësimdhënies; respektimi i procedurave; korrektesa; përfshirja në projekte dhe aktivitete; cilësia e bashkëpunimit; anagazhimi me studentët dhe integriteti akademik dhe profesional.<br><br>*Evidenca Nr. 20: Katalogu i Fakultetit, kapitulli 12*<br>*Evidenca Nr. 6: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, kapitulli 5*<br>*Evidenca Nr. 13: PEP formualri i Vlerësimit të stafit* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Stafi akademik i Akademia NG vlerësohet në mënyrë periodike nga studentët përmes formularëve të cilët përmbajnë disa indikatorë vleresimi që përfshijnë: Metodologjinë e mësimdhënies; aftësinë e organizimitë të modulit; angazhimin e pedagogut; nivelin e kërkesës; arritjet dhe integritetin akademik.<br><br>*Evidenca Nr. 13: PEP formualri i Vlerësimit të stafit* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | GVJ konstaton se strukturat drejtuese të Akademia NG vlerësojnë për cdo vit Formularin e Vlerësimit dhe Planifikimit të Performancës (PEP) për të gjithë personelin akademik të njësisë kryesore, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Rezultatet e vlerësimit janë objekt diskutimi dhe vlerësimi. Gjithashtu, personeli akademik |

| | |
|---|---|
| | vlerësohet dhe nga vetë studentët në përfundim të semestrit përpara provimit përfundimtar.<br><br>*Evidenca Nr. 13: PEP formualri i Vlerësimit të stafit*<br>*Evidenca Nr. 14: Formulari i Vlerësimit të Moduleve* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | GVJ konstaton dhe nga vizita me përgjegjësit e Cilësisë, se Drejtuesi i Menaxhimit të Cilësisë dorëzon rezultatet e formularëve të vlerësimit te drejtuesi i njësisë kryesore të Fakultetit. Gjithashtu, studentët plotësojnë për cdo vit Pyetsorin e Shërbimit Studentor, i cili përfshin kriteret e vlerësimit që lidhen me procesin e këshillimit akademik të ofruar nga fakulteti. Rezultatet e pyetësorit dorëzohen nga Drejtuesi i Menaxhimit të Cilësisë tek Dekani për marrjen e masave të nevojshme në shërbim të ruajtjes dhe garantimit të cilësisë.<br><br>*Evidenca Nr. 13: PEP formualri i Vlerësimit të stafit*<br>*Evidenca Nr. 14: Formulari i Vlerësimit të Moduleve*<br>*Evidenca Nr. 6: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, seksioni 5* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia NG disponon dhe zbaton politika dhe procedura për garantimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe harton formularë të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | GVJ konstaton se Akademia NG disponon një Plan Vlerësimi të institucionit i cili përfshin: proceset e vlerësimit sistematik dhe periodik të programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti; performancës së arritjeve akademike të studentëve si dhe arritjeve të të diplomuarve. Gjithashtu, Stafi akademik i fakultetit dhe ai administrativ, është angazhohen në procesin e vlerësimit të programeve të studimit si dhe në nxjerrjen e statistikave për të gjithë studentët. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca Nr. 41: Vlerësimi i Rezultateve të të Nxënit të Studentëve të programit M.Sc.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | GVJ konstaton se Akademia NG zbaton një Plan Vlerësimi i cili përfshin: proceset e vlerësimit sistematik dhe periodik të programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti; performancës së arritjeve akademike të studentëve si dhe arritjeve të të diplomuarve. Formati duhet të plotësohet për çdo program studimi dhe merr në konsideratë të gjitha fushat duke përfshirë regjistrimin, shkallën e mbarëvajties, krahasueshmërinë e programit, burimet nga biblioteka, rezultatet e të mësuarit, analizën SWOT dhe rekomandimet strategjike për ndryshime. Ai plotësohet në kuadër të rishikimit të programit dhe i shpërndahet Fakultetit dhe Komisionit të Kurrikulës.<br>***GVJ rekomandon që në përmbushje të përgjegjësive dhe për të garantruar sigurinë e cilësisë, duhet të krijohet hapësira e dedikuar në faqen web të institucionit "Njësia e sigurimit të cilësisë" ku të bëhën transparente për të interesuarit: formatet e vlerësimit; indikatorët matës si dhe rezulatetet dhe raportet e vlerësimit periodik vjetor për fushat e vlerësuara sipas planit të vlerësimit.***<br>*Evidenca Nr. 5: Statuti i Akademisë „Nehemiah Gateway "(neni 83, pika 1)*<br>*Evidenca Nr. 6: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, seksioni 6* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | GVJ konstaton se Institucioni ka krijuar instrumentet e duhura për vlerësimin e programeve të tij të studimit. Gjithashtu, programet janë të akredituar nga agjencia gjermane e akreditimit, FIBAA. Akademia "Nehemiah Gateway" u riafirmua në vitin 2022 me statusin e akredituar institucionalisht nga agjencia amerikane e akreditimit, TRACS, për një periudhë 10-vjeçare.<br><br>***GVJ rekomandon që në përmbushje të përgjegjësive dhe për të garantruar sigurinë e cilësisë, duhet të krijohet hapësira e dedikuar në faqen ëeb të institucionit "Njësia e sigurimit të cilësisë" ku të bëhën transparente për të interesuarit: formatet e vlerësimit; indikatorët matës si dhe rezulatetet dhe raportet dhe rezulatet e ndryshme të vlerësimit periodik vjetor për fushat e vlerësuara sipas planit të vlerësimit.*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, | GVJ konstaton se përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhë kërkim për pasqyrimin dhe përmriësimin e cilësisë. Për të vlerësuar arritjet e studentëve, përdoren lëndët bazë të kurrikulës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | përmes një studimi të detajuar që shqyrton detyrat e studentëve në bashkëpunim me Drejtuesin e Qendrës Kërkimore. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në përshtatjen e kurrikulave për të mbështetur efikasitetin e mësimdhënies dhe për të siguruar cilësinë e kurrikulës.<br><br>*Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ se Akademia NG harton dhe zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Msc Menaxhim me Profil Biznes në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. GVJ rekomandon që në përmbushje të përgjegjësive dhe për të garantruar sigurinë e cilësisë, duhet të krijohet hapësira e dedikuar në faqen ëeb të institucionit "Njësia e sigurimit të cilësisë" ku të bëhën transparente për të interesuarit: formatet e vlerësimit; indikatorët matës si dhe rezulatetet dhe raportet dhe rezulatet e ndryshme të vlerësimit periodik vjetor për fushat e vlerësuara sipas planit të vlerësimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe | GVJ konstaton se Akademia NG zbaton një Plan Vlerësimi i cili përfshin: proceset e vlerësimit sistematik dhe periodik të programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti; performancës së arritjeve akademike të studentëve si dhe arritjeve të të diplomuarve. Formati duhet të plotësohet për çdo program studimi dhe merr në konsideratë të gjitha fushat duke përfshirë regjistrimin, shkallën e mbarëvajtjes, krahasueshmërinë e programit, burimet nga biblioteka, rezultatet e të mësuarit, analizën SWOT dhe rekomandimet strategjike për ndryshime. Ai plotësohet në kuadër të rishikimit të programit dhe i shpërndahet Fakultetit dhe Komisionit të Kurrikulës. |





| | |
|---|---|
| arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | *Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | GVJ konstaton se përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhë kërkim për pasqyrimin dhe përmriësimin e cilësisë. Për të vlerësuar arritjet e studentëve, përdoren lëndët bazë të kurrikulës përmes një studimi të detajuar që shqyrton detyrat e studentëve në bashkëpunim me Drejtuesin e Qendrës Kërkimore. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në përshtatjen e kurrikulave për të mbështetur efikasitetin e mësimdhënies dhe për të siguruar cilësinë e kurrikulës. Ky program studimi akreditohet për herë të parë, kështuqë do duhet të pritet vlerësimi nga Bordi Areditimit për të vijuar me ndryshimet dhe përshtatjet e mundshme të programit të studimit me kërkesat e tregut.<br><br>*Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.* |
| **Kriteri 3.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i | GVJ konstaton se Akademia NG përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit MSc Menaxhin me profil në biznes. Gjithashtu, përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhë kërkim për pasqyrimin dhe përmriësimin e cilësisë. Për të vlerësuar arritjet e studentëve, përdoren lëndët bazë të kurrikulës përmes një studimi të detajuar që shqyrton detyrat e studentëve në bashkëpunim me Drejtuesin e Qendrës Kërkimore. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në përshtatjen e kurrikulave për të mbështetur efikasitetin e mësimdhënies dhe për të siguruar cilësinë e kurrikulës.<br><br>Drejtuesi i Menaxhimit të Cilësisë dorëzon rezultatet e formularëve të vlerësimit te drejtuesi i njësisë kryesore të Fakultetit. Gjithashtu, studentët plotësojnë për cdo vit Pyetsorin e Shërbimit Studentor, i cili përfshin kriteret e vlerësimit që lidhen me procesin e këshillimit akademik të ofruar nga fakulteti. Rezultatet e pyetësorit dorëzohen nga Drejtuesi i Menaxhimit të Cilësisë tek Dekani për marrjen e masave të nevojshme në shërbim të ruajtjes dhe garantimit të cilësisë. |

| | |
|---|---|
| shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | *Evidenca Nr. 13: PEP formualri i Vlerësimit të stafit*<br>*Evidenca Nr. 14: Formulari i Vlerësimit të Moduleve*<br>*Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | GVJ konstaton se një tjetër pyetësor i përdorur si mjet matës është "Pyetësori për Alumnin" me qëllim për të mbledhur informacione mbi programin nga studentët që janë diplomuar. Ky pyetësor dërgohet për tu plotësuar pas dy viteve pas diplomimit me mundësi ripërsërtije. Drejtuesi i njësisë së Cilësisë dhe / ose Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-Shkencore janë përgjegjës për hartimin, mbledhjen, analizimin dhe dërgimin e rezultateve te Përgjegjësi i Departamenteve dhe Dekanit dhe më pas diskutohen në Mbledhjen e Fakultetit dhe Komisionin e Kurrikulës.<br>Gjithashtu, studentët plotësojnë për cdo vit Pyetsorin e Shërbimit Studentor, i cili përfshin kriteret e vlerësimit që lidhen me procesin e këshillimit akademik të ofruar nga fakulteti. Rezultatet e pyetësorit dorëzohen nga Drejtuesi i Menaxhimit të Cilësisë tek Dekani për marrjen e masave të nevojshme në shërbim të ruajtjes dhe garantimit të cilësisë.<br><br>*Evidenca Nr. 13: PEP formualri i Vlerësimit të stafit*<br>*Evidenca Nr. 14: Formulari i Vlerësimit të Moduleve*<br>*Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.*<br>*Evidenca Nr. 40: Template i pyetësorëve të Alumni* |
| **Konkluzione** | *GVJ vëren se institucioni monitoron periodikisht cilësinë dhe i përdor këto të dhëna për të adresuar problematikat e identifikuara dhe replikuar praktikat e mira.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve | GVJ konstaton se Akademia NG, realizon cdo tre vite dhe Vlerësimin e Tregut për të kuptuar nevojet e kërkesës së punës si dhe për të identifikuar kualifikimet profesionale të kerkuara në nivel kombëtar dhe më gjerë. Kjo përdoret për të mbledhur informacion rreth nevojave të tregut (kriteret e punësimit). Vlerësimi realizohet |

| | |
|---|---|
| të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | nga Përgjegjësi i njësisë bazë për programin e studimit në bashkëpunim me Drejtuesin e Menaxhimit të Cilësisë të Akademia NG. GVJ konstaton se një tjetër pyetësor i përdorur si mjet matës është "Pyetësori për Alumnin" me qëllim për të mbledhur informacione mbi programin nga studentët që janë diplomuar.<br><br>https://www.ng-university.org/application/files/5416/8691/9625/Retention_Graduation_and_Job_Placement_Rate_2023.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | GVJ konstaton se Njësia e Sigurisë së Cilësisë brenda Akademisë "Nehemiah Gateëay" ka përgjegjësi të përcaktuara qartë lidhur me vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, aktiviteteve kërkimore të programeve që ajo ofron, por dhe për vlerësimin e performancës së studentëve të programeve të studimit. Njesia e sigurimit ka një sërë funksionesh, si: mbajtja e komunikimit me agjencinë e akreditimit; drejtimin e proceseve të akreditimit; propozimin e kritereve për përmirësimin e cilësisë; vlerësimin periodic të pyetësorëve; kryerjen e studimeve mbi punësimin potencial të studentëve.<br><br>*Evidenca Nr. 5: Statuti i Akademisë „Nehemiah Gateway "(neni 83, pika 1)*<br>*Evidenca Nr. 6: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë te programit të studimit përfshihet njësia bazë (Deparatamenti) dhe kryesore (dekanati Fakultetit Ekonomik), që është përgjegjës për programin e studimit, anëtarë të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentë të programit të studimit. Gjthëpërfshirja e sa me shumë aktorve (palëve të interesuara) në vlerësimin e cilësisë i shërben rritjes së vazhdueshme të saj.<br><br>*Evidenca Nr. 6: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, seksioni 4* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë | Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të cilësisë në Akademia NG respekton integritetin akademik dhe shmang cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Koordinimi i procesit të vlerësimit është përgjegjësi e Drejtuesit të Menaxhimit të Cilësisë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Programet e studimit në Akademinë "NG" rishikohen çdo pesë vjet për qëllime të akreditimit të programit me FIBAA, ASCAL dhe TRACS.<br><br>*Evidenca Nr. 6: Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë* | | | |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Programet e studimit në Akademinë "NG" rishikohen çdo pesë vjet për qëllime të akreditimit të programit me FIBAA, ASCAL dhe TRACS.<br><br>*Evidenca Nr. 6: Assesment Plan*<br>*Evidenca Nr. 17: Strtaegic Plan*<br>**https://www.ng-university.org/en/admissions/accreditation** | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Akademia NG ka politika të qarta për promovimin dhe sigurimin e cilësisë si dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm të IAL në këtë proces.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushe t pjesërisht** | **Përmbushe t kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Akademia NG realizon rishkimi e rregullt dhe periodik të Programit të Studimit dhe gjetjet prezantohen në mbledhjen e njësisë kryesore përgjegjëse për programin MSc Menaxhim me profil Biznes. Përdoren një set vlerësimesh që përfshijnë: rishikimin e Katalogut të Moduleve; Studmi i Tregut si dhe Formati i Vlerësimit të Programit. Gjetjet e raporteve përcillen në Mbledhjen e Fakultetit dhe Komisionin e Kurrikulës.<br><br>*Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.* |





| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ konstaton se Akademia NG zbaton një Plan Vlerësimi i cili përfshin: proceset e vlerësimit sistematik dhe periodik të programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti; performancës së arritjeve akademike të studentëve si dhe arritjeve të të diplomuarve. Formati duhet të plotësohet për çdo program studimi dhe merr në konsideratë të gjitha fushat duke përfshirë regjistrimin, shkallën e mbarëvajties, krahasueshmërinë e programit, burimet nga biblioteka, rezultatet e të mësuarit, analizën SWOT dhe rekomandimet strategjike për ndryshime. Ai plotësohet në kuadër të rishikimit të programit dhe i shpërndahet Fakultetit dhe Komisionit të Kurrikulës.<br>*Evidenca Nr. 6: Assesment Plan*<br>https://www.ng-university.org/al/staff-menu/download-center |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | GVJ konstaton se përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për pasqyrimin dhe përmriësimin e cilësisë. Për të vlerësuar arritjet e studentëve, përdoren lëndët bazë të kurrikulës përmes një studimi të detajuar që shqyrton detyrat e studentëve në bashkëpunim me Drejtuesin e Qendrës Kërkimore. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në përshtatjen e kurrikulave për të mbështetur efikasitetin e mësimdhënies dhe për të siguruar cilësinë e kurrikulës.<br><br>*Evidenca Nr. 6: Assesment Plan*<br>*Evidenca Nr. 42: Rishikimi i Programit të studimit M.Sc.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Programet e studimit në Akademinë "NG" rishikohen çdo pesë vjet për qëllime të akreditimit të programit me FIBAA, ASCAL dhe TRACS. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në përshtatjen e kurrikulave për të mbështetur efikasitetin e mësimdhënies dhe për të siguruar cilësinë e kurrikulës.<br><br>*Evidenca Nr. 6: Assesment Plan*<br>*Evidenca Nr. 17: Strtaegic Plan*<br>**https://www.ng-university.org/en/admissions/accreditation** |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Përfshrija e personelit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm te cilësisë garantohet nga përfshitja e tyre në strukturat e garantimit të cilesisë. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet, rregulloreve, studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (NJBSC, Senati Akademik, Zyra e Studentit. Java e orientimit-që zhvillohet në fillim të vitit akademik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ vëren se institucioni zhvillon procese dhe veprimtari të cilat janë publike dhe në tërësi efikase për krijimi dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |





**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Menaxhim"me profil në "Biznes" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Nehemiah Gateway"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Institucioni siguron mbështetje gjithëpërfshirëse për studentët, duke kombinuar asistencën akademike, infrastrukturore dhe sociale me përgatitjen për tregun e punës. Në këtë mënyrë, krijohet një mjedis pozitiv që promovon komunikimin e hapur, shprehjen e mendimit të lirë dhe zhvillimin personal e profesional. Përmes qasjes së integruar, studentët gjejnë mbështetje në çdo aspekt të procesit mësimor dhe jetës studentore, ndërsa u ofrohen mundësi për të zhvilluar ide inovative dhe për të kontribuar në kërkimet shkencore.
2. Programi siguron mundësi bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta dhe aktorë të biznesit, duke kontribuar në zhvillimin profesional të studentëve dhe mundësitë për punësim pas diplomimit.
3. Infrastruktura e përshtatshme dhe lokacioni i disponueshëm krijojnë kushte ideale për realizimin e procesit mësimor, ndërkohë që sistemet efikase të menaxhimit të informacionit dhe platforma online mundësojnë një ndërveprim të vazhdueshëm mes studentëve, pedagogëve dhe institucioneve. Burimet njerëzore, infrastruktura dhe logjistika janë të plota dhe përmbushin standardet për ofrimin e një programi cilësor dhe të suksesshëm, duke siguruar mbështetje për realizimin e objektivave të programit. Përshtatshmëria e ambienteve dhe faciliteteve për studentët, së bashku me mbështetjen e vazhdueshme nga personeli akademik, mundësojnë një eksperiencë mësimore të plotë dhe të suksesshme.
4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit ofron një program të strukturuar, të organizuar dhe informues që garanton një proces të mirëfilltë të të nxënit dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore me metodat dhe praktikat më të mira. Stafi akademik, i cili përbëhet nga profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë ndërkombëtare, angazhohet në realizimin e këtyre objektivave, duke krijuar një mjedis mësimor të pasur dhe stimulues për studentët.

**Pika të dobta**

1. Numër i vogël i studentëve dhe marketingu i pamjaftueshëm.

**Rekomandime**

1. Të intesifikohen përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve.
2. Të zhvillohen më shumë iniciativa dhe të zgjerohet gama e aktiviteteve ku të përfshihen studentët

në studime, projekte apo aktivitete kërkimore shkencore.
3. Të intensifikohen përpjekjet për projekte/grante kombëtare/ndërkombëtare dhe programe mobiliteti.

**Evaluation conclusions of the second cycle study program Master of Science "Management" with a profile in "Business" offered by the Higher Education Institution "Nehemiah Gateway Academy"**

**Strengths and affirmations**

1. The institution provides comprehensive support for students, combining academic, infrastructural and social assistance with preparation for the labor market. In this way, a positive environment is created that promotes open communication, free expression of thought and personal and professional development. Through an integrated approach, students find support in every aspect of the learning process and student life, while they are offered opportunities to develop innovative ideas and contribute to scientific research.
2. The program provides opportunities for cooperation with institutions, companies, third parties and business actors, contributing to the professional development of students and employment opportunities after graduation.
3. The appropriate infrastructure and available location create ideal conditions for the implementation of the learning process, while efficient information management systems and online platforms enable continuous interaction between students, lecturers and institutions. Human resources, infrastructure and logistics are complete and meet the standards for providing a qualitative and successful program, providing support for the realization of the program objectives. The suitability of the premises and facilities for students, together with the continuous support of the academic staff, enable a complete and successful learning experience.
4. The unit responsible for the study program offers a structured, organized and informative program that guarantees a genuine learning process and the development of professional and scientific skills with the best methods and practices. The academic staff, which consists of qualified professionals with international experience, is engaged in the realization of these objectives, creating a rich and stimulating learning environment for students.

**Weaknesses**

1. Small number of students and insufficient marketing.

**Recommendation**

1. Intensify efforts to increase the number of students.
2. Develop more initiatives and expand the range of activities involving students in studies, projects or scientific research activities.
3. Intensify efforts for national/international projects/grants and mobility programs.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |



